

Tirana voton
Protokollin për
Maqedoninë
në NATO

Fq.6



USHQIMI
I TEPËRT
Ligji që do të
"ushqente"
të varfrit

Fq.7



Bota ka
ende
nevojë
për
NATO-n

Fq.10



Koha

www.koha.mk



Argjentinasi
hanë futboll!

Fq.18

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3585 · e premte, 15 shkurt 2019

1°C | 8°C

15 DEN

FORUM

Kriza e
Kosovës dhe
zgjidhja që
duket ende
e largët



Si këto ditë 20 vjet më parë, në Rambouillet të Francës filloi konferenca ndërkombëtare e paqes për konfliktin që zgjaste disa dekada midis Serbisë dhe Kosovës, të banuar nga shqiptarët. Beogradi nuk...

Fq.10

RAJON

Cilat janë
kërkesat e
investitorëve
gjermanë në
Shqipëri?

Fq.14


KULTURË

35-vjetori i
vdekjes së
fotografit
shqiptar
Gjon Mili

Fq.16



UDHËTIMI TRAGJIK QË PËRFUNDOI NË LASKARCË



Bëhet fjalë për viktime dhe të lënduar të moshës së re. Zaten, në linjën e autobusëve të kompanisë "Durmo-Tours" në relacionin Gostivar-Shkup dhe anasjelltas, kryesisht udhëtojnë qytetarë të rinj, të cilët janë të angazhuar me punë ose janë studentë në Shkup. Kjo vërtetohet edhe nga lista e viktimave, ku pjesa dërmuese janë nën moshën 30-vjeç

Fq.3-5

ANALIZË

HISTORI TË ÇMENDURA DHE FAKTE TURPI

Nga ARTAN FUGA

T'u japim vend edhe fakteve madhështore, por edhe fakteve të turpshme në historinë tonë. Kjo është histori "objektive", t'i lemë pasionet e mbështetura në zbulimin e së kaluarës. Vetëm këta dy shekujt e fundit kemi bërë gjëra heroike, por edhe gabime kolektive që i kalojmë ashtu shkara-zi, "hajdutshe", si vogëlma pa rëndësi. Çfarë do të na thoshte dikush nga jashtë nëse do të kishte vrotuar veprimet tona historike?

Ja, që mjaft shqiptarë në kohën e Luftës së Parë botërore pajtoheshin me qira si ushtarë në ushtritë e huaja që gjendeshin te ne dhe luftonin me njeri-tjetrin për pesë kacidhe ora e luftës. Po ja, që mijëra shqiptarë nën udhëheqjen jo vetëm të Haxhi Qamilit, minonin ngritjen e flamurit të Pavarësisë. Po ja, që kishte pjesë të elitave politike, fetare, artistike që mezi prisnin pushtimin italian të vendit dhe që nuk bënë asnjë veprim kundër pushtuesve, veç mbretit që iku si zog. Po ja, që dhjetëra deputetë shqiptarë, bij të "familjeve të mëdha", u bënë pro pushtues dhe shumë prej tyre vajtën në Itali dhe i dhuruan perandorit kurorën e mbretërisë shqiptare që u bë nënmbretëri. Po ja, që Parlamenti shqiptar, pa pikë turpi, i shpalli luftë Greqisë fqinje dhe historianët nuk e botojnë vendimin e tij fashist. Po ja, që gazetaret kryesorë në vitet '40 ishin pro Hitlerit dhe nazizmit dhe antiçifute? Ne përkujtojmë që, ne si populli, jo si elita, i kemi mbrojtur çifutët dhe kjo duhet të na bëjë të harrojmë gjithçka tjetër, edhe ndonjë mendësi të vockël genocidiste në mediat e kohës. Po ja, që pas Luftës së Dytë Botërore, gazetaret komuniste ishin sllavofile, duke i quajtur kombet sllave si më të lartat dhe antieuropiane? Po ja, që në Konferencën e Parisit, pas Luftës së Dytë Botërore, Greqia donte të na shpërbente, kurse Jugosllavia të na mbronte. (Sigurisht, për hesap të vet, pse kot?) Po ja, që iu dorëzuam serbëve gjithçka, me ushtri, me pare, me sekrete, me të gjitha duke u bashkuar de fakto dhe se po të mos ishte ai diktatori me mustaqe në Rusi, do të ishim bërë qytetarë të Maqedonisë. Askush nga ne nuk lëvizti. Po ja, që në kuadrin e Traktatit të Varshavës iu dhamë rusëve të drejtën që sa herë të donin të hynin ushtarakisht në Shqipëri, madje pa pyetur kurrkënd. Askush nuk tha jo. Po ja, që pati mijëra shqiptarë që u bënë spiunë dhe kishe frikë të thoshe një fjalë se spiuni dëgjonte. Ku janë këta spiunët? Po ja, që aty nga vitet '60 të shekullit të kaluar u bëmë prapë me Titon nga frika e muzhikut që zbriti me tanke në Pragë dhe kosovarët ishin titistë? Po ja, që për 50 vjet jetonim me thërrimet që na jepnin jugosllavët, rusët, kinezët? Po ja, që gërthisnim me histori, rroftë ky e rroftë ai, në mitingjet masive të viteve '50 apo '60 të shekullit të XX. Po ja, që mijëra të rinj hipën në çatitë e kishave dhe xhamive në mesin e viteve '60 duke iu hequr tjegullat, nuk e dini? Shihni dokumentarët, ka plot. Po ja, që merrnin nisma fshatshe e qytetshe për të ulur rrogat e vetvetes? Po ja, që donin ta fitonim jetën pa punuar, nuk e kishte fajin Sudja dhe u bëmë si Pinoku që mbolli lekët dhe prisnim të rriteshin si pemë. Po ja, që shitëm me dhi e katandi për të vendosur lekët në firmat piramidale e marrë interesa, që në fakt ishin paret e komshiut. Po ja, që pasi u vramë me njëri-tjetrin, thirrëm në ndihmë kalabrezë, rumunë, turq, grekë, që të na ndanin në vitin 1997, sepse po i hanim kokën njëri-tjetrit. Po ja, që kurrë nuk kemi bërë zgjedhje të ndershme sepse sa herë dikush fiton, tjetri e quan hajdut votash. Po ja, që nuk kemi industri dhe askush nuk shkon të punojë askund, se i duket se është bërë vetëm për të qenë sociolog, historian, ekonomist a pianist. Po ja, që si asnjë popull tjetër, sado në vështirësi, morëm anijet dhe lamë pendët duke ikur sa më larg, larg, braktisur gjithçka. Po ja, që kemi vite dhe pasi ëndërruam me shekuj bashkimin kombëtar, tani me Kosovën, jemi si çift i ftohur në prag të divorcit! Edhe kosovarët që vijnë në plazhet e Adriatikut dhe Jonit na renden. Po ja, që gjithmonë kemi gjetur shpëtim duke u lidhur pas qerres së perandorive të mëdha, romake, osmane, austro-hungareze, ruse, kineze, etj., etj. dhe sapo kemi parë fundin e njëjës, hop, jemi hedhur te gjiri i tjetrës, duke ndryshuar fe e besë masivisht.

Denoj çdo deklaratë që mbjell urrejtje

"Si njeri, si prind, si profesor, si ministër jam i shokuar nga një pseudo perfaqësuese e komunitetit akademik që në thelb duhet të jetë bashkësia më e ngritur dhe kohezive e një shoqërie, posaçërisht atyre multietnike siç është shoqëria jonë.

Denoj çdo deklaratë që mbjell urrejtje dhe nxitje e cila në këto momente të vështira tragjedi nuk sjell asgjë tjetër përveçse përçarje të reja!

Përgjegjësia duhet të pasoj pa asnjë vonesë dhe pres nga universiteti dhe bota akademike që të reagojnë.

Ngushëllime viktimave, shqiptarë, maqedonas dhe të tjerë, sonte ndajm dhimbjen me familjarët e tyre", ka shkruar një status në Facebook, ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi.

Një aksident tragjik shokues!

"Te dashur miq, arriti në 14 te vdekur dhe 40 te plagosur disa prej të cilve rende bilanci shokues tragjik i aksidentit me një autobus në linjen Tetovë-Shkup. Duke shprehur ngushëllimet me te ndjera familjeve te viktimave dhe autoriteteve të Maqedonisë së Veriut, i lutem Zotit dhe uroj shërim të shpejte për te plagosurit!", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, ish kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha.

Burrat e parlamentit Shqiptar luajnë ende me llastiqe

"Burrat e parlamentit Shqiptar luajnë ende me llastiqe, me vezë, miell, bojë, thyejnë xhamat e njeri-tjetrit, luajn; tokash e ne presim të bëjnë ligje, të marrin vendime, të merren me të nesërmen e fëmijëve tane. Burrave të parlamentit tonë, u ngrihen qimet përjetë vetëm po i shave nga mami, motra , grua. U shofshi se na shkatërruat e na bëte rezil!", ka shkruar një status në Facebook, poetja Brikena Qama, me banim në Athinë

MEDIACitate

Mogherini: SHBA dhe BE nuk pajtohen rreth Iranit

Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian (BE) për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Federica Mogherini, tha se ekzistojnë çështje mbi të cilat nuk ndajnë mendimin të njëjtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Mogherini ka dhënë deklaratë për mediat në shtabin e NATO-s, në të cilën arriti për të marrë pjesë në takimin e ministrave të mbrojtjes të Aleancës.

Përfaqësuesja e lartë para-lajmëroi takimin me ministrin e Mbrojtjes të Maqedonisë së Veriut, Radmilla Shekerinska, duke kujtuar se Bashkimi Evropian (BE) që nga fillimi fuqishëm ka mbështetur zgjidhjen e kontestit për emrin me Greqinë.

Mogherini në takimin e ministrave të mbrojtjes të NATO-s dhe partnerëve evropianë do të flasë për hapat që Evropa i ka marrë në fushën e sigurisë.

"Një BE më e fuqishme në fushën e mbrojtjes do të fuqizojë NATO-n dhe do të mundësojë siguri në kontinent", tha Mogherini.

E pyetur pse nuk merr pjesë në Konferencën e Lindjes së Mesme në Poloni, Mogherini tha se bashkëpunimi BE-NATO është i rëndësishëm dhe për këtë arsye merr pjesë në takimin e ministrave të mbrojtjes të NATO-s. Përfaqësuesja e lartë e BE-së rikujtoi se Brukselin nesër do ta vizitojë sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo.

"Ka çështje për të cilat kemi qëndrime të përbashkëta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka edhe çështje me të cilat nuk pajtohemi. Kemi pikëpamje të ndryshme mbi marrëveshjen bërthamore me Iranin", rikujton Mogherini.

(Anadolu Agency,
14 SHKURT)

VIKTIMAT



- Rametulla Abdurraimi (1998) nga fshati Debresh - djalë i vetëm i familjes Abdurraimi - Valdete Hamiti, Debresh - asistente në Fakultetin e Informatikës në UNT



- Jovica Trpevski, djali 25-vjeç i deputetit Bllagojçe Trpevski nga Gostivari



- Besim Kamberi, rreth 33 vjeç, nga fshati Senakos i Vrapçishtit



- Onur Sadiku, 19-vjeçar nga Gostivari
- Esat Emruli nga Gostivari



- Ajdin Ismaili, 19 vjeç nga Gostivari
- Arce Arsoški nga Gostivari
- Bejza Uzeiri (1998) nga Banjica e Poshtme
- Zoran Davidovski (1981), nga Tetova, punonjës në Qytetin e Shkupit
- Tërpana Janevska, pensioniste nga Gostivari
- Boban Avramovski nga fshati Zubovcë, 19-vjeçar - student i FON-it
- Dejan Risteovski, i punësuar në Bankën Popullore të Maqedonisë
- Pavle Kostoski, nga Gostivari, i sapo diplomuar në Fakultetin Juridik në Shkup.

UDHËTIMI TRAGJIK QË PËRFUNDOI NË LASKARCË



Bëhet fjalë për viktimë dhe të lënduar të moshës së re. Zaten, në linjën e autobusëve të kompanisë "Durmo-Tours" në relacionin Gostivar-Shkup dhe anasjelltas, kryesisht udhëtojnë qytetarë të rinj, të cilët janë të angazhuar me punë ose janë studentë në Shkup. Kjo vërtetohet edhe nga lista e viktimave, ku pjesa dërmuese janë nën moshën 30-vjeç

Koha

Ekipi i gazetës KOHA

së, ju përshëndeti ju kolegëve", theksoi Zaev.

Shkup, 14 shkurt - Republika e Maqedonisë së Veriut është në zi, ndërsa Qeveria dhe institucionet tjera, si dhe ambasada amerikane në Shkup i kanë ulur flamujt në gjysëm shtizë, për shkak të tragjedisë të së mërkurës ku jetën e humbën 14 udhëtarë të autobusit të kompanisë "Durmo Tours", ndërsa mbi 30 të tjerë u lënduan. Krerët shtetëror dhe liderët partiak në vend kanë shprehur ngushëllimet e tyre për familjet që kanë humbur me të dashurit e tyre, ndërsa nuk kanë munguar as reagimet e liderëve dhe mediave të rajonit. Madje, Qeveria e Kosovës dhe Parlamenti i Republikës së Shqipërisë, punimet e së enjtes i filluan me një minutë heshtje për viktimat e "Lasakarcës".

Por, kush ishin viktimat? Autoritetet thanë se kryesisht bëhet fjalë për viktimë dhe të lënduar të moshës së re. Zaten, në linjën e autobusëve të kompanisë "Durmo-Tours" në relacionin Gostivar-Shkup dhe anasjelltas, kryesisht voziten qytetarë të rinj, të cilët janë të angazhuar me punë ose janë studentë në Shkup. Kjo vërtetohet edhe nga lista e viktimave, ku pjesa dërmuese janë nën moshën 30-vjeç. Edhe kryeministri Zoran Zaev, pas vizitës që ua bëri të lënduarve që po kurohen në spitalin "8 Shtatori", theksoi se pjesa më e madhe e të lënduarve janë të moshës së re. "I pashë të gjithë të lënduarit të cilët janë jashtë rrezikut për jetë. Bëhet fjalë për qytetarë të moshës së re. Fola me një djalë i cili kishte 19 vjet dhe me një vajzë të po të njëjtës moshë. Fola edhe me zëdhënësen e EVN-

GJURMË GJAKU GJITHANDEJ

Autobusi i shpërndarë në pjesë-pjesë, gjurmë të gjakut e mbetje tjera nga udhëtarët e vdekur dhe të lënduar, paraqesin fotografinë e zymtë nga vendi tragjik në fshatin Llaskarcë të Shkupit, ku pasditen e 13 shkurtit humbën jetën 14 banorë të Gostivarit dhe rrethinës, ndërsa mbi 30 tjerë u lënduan. Kompania e autobusëve "Durmo Tours", në pronë të cilës ishte autobusi i aksidentuar, sipas Ministrisë për Transport dhe Lidhje, ka qenë e pajisur me të gjitha lejet dhe autorizimet. Në deklaratën e tij, ministri Goran Sugarevski, tha se kompania në fjalë lejet valide të transportit i ka pasur deri në vitin 2023, duke theksuar se për gjendjen teknike të autobusëve - përgjegjësia bie mbi Ministrinë për Transport dhe Lidhje.


Gjatë ditës së enjte, ekupe të MPB-së dhe Prokurorisë së Shkupit kanë kryer kontroll në vendin e ngjarjes. Lëndë shqyrtimi e autoriteteve përkatëse ka qenë mënyra e frenimit të autobusit, gjatësia e saj dhe shkaqet që kanë ndikuar në rrokullisjen e autobusit nga rruga magjistralë në atë lokale, gjatësia e të cilës sipas dëshmitarëve okular - është deri në 30 metra. Piktori nga Gostivari, Reshat Ahmeti, një pasagjer i rregullt i kësaj kompanie, i cili fatmirësisht të mërkurën nuk kishte udhëtuar me këtë autobus, për gazetën KOHA tregon se për banorët e Gostivarit dhe fshatrave përreth, kjo linjë është më rëndësi pasi e njëjta lëviz direkt nga Gostivari drejt Shkupit. "Fati i madh ishte që nuk isha të




Valdete Hamiti



Trpana Janevska



Pavle Kostoski



Boban Avramovski



Zoran Davidovski



Esat Emruli

mërkurën në atë autobusë. Interesi për këtë linjë është i lartë, pasi ajo drejt Gostivarit, nga Shkupi nisat në ora 16:15, vetëm disa çaste pasi administrata e shtetit përfundon me punë. Shpeshherë nuk ka vende të lira në autobusë", thotë, piktori Ahmeti.

GJITHÇKA KISHTE NDODHUR SHPEJTË

Nga ana tjetër, një i punësuar në Ministrinë e Ekonomisë i cili ë shfrytëzon për çdo ditë këtë linjë të autobusit për të ardhur dhe vajtur nga puna, dhe i cili fatmirësisht ka shpëtuar me lëndime të lehta trupore, kë rrëfyer tmerrin që ka



përjetuar ai dhe të gjithë pasagjerët tjerë që kanë pësuar në këtë fatkeqësi. "Në ora 16 e 15 minuta dola nga puna, nga Ministria e Ekonomisë. Diku ka ora 16 e 30 minuta u nisëm nga stacioni Simpo-Karposh. Më kujtohet, isha i ulur në karrigen e tretë jo nga ana e shoferit, por nga ana tjetër, dhe në një moment rrugës filloi të trokas autobusi dhe e pashë se nuk ishte diçka në rregull. U ngrita në këmbë, mendova mos e ka zënë gjumi shoferin, por pashë se ai e kishte shtrënguar fortë timonin, u mundova të kërcej te shoferi që ta mbajë drejtimin, por në atë rast e humbi drejtimin dhe kaloi në anën tjetër, në drejtim të rrugës Tetovë-Shkup, për fat të mirë nuk kishte vetura të tjera. E shpërngova fortë karrigen dhe më kujtohet vetëm se momenti i përplasjes së autobusit në asfalt, dhe në atë moment mbajë mend se dola nga dritarja e autobusit dhe kam të lënduar krahun dhe shpatullën. Afër meje ka qenë një djalë nga Shqipëria. Fillimisht katër të lënduar me një veturë të markës Golf dhe me disa vetura tjera i kemi transferuar në spital, ndërsa më pas ka intervenuar Ndihma e Shpejtë", deklaroi dëshmitari i mbijetuar i kësaj tragjedie.

Ndërkaq, një familjar i Jeton Ismailit, i cili po kurohet në Spitalin e Shkupit, thotë se janë dëgjuar me telefon në momentin kur ka ndodhur fatkeqësia dhe se vet ai i ka informuar për tragjedinë. "Pas aksidentit, Jetoni është paraqitur vetë me telefon në shtëpi dhe ka informuar për tragjedinë", ka dek-

ASGJË S'MUND TË KRAHASOHET ME KËTË TRAGJEDI

Kjo është një nga tundimet më të tmerrshme në qytetin tonë, tha kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, i cili mbajti fjalim në seancën komemorativë me rastin e vdekjes në fatkeqësinë e komunikacionit që ndodhi të mërkurën afër fshatit Laskarcë. Ai i bëri thirrje shtetit që ti ndihmon sa është e mundur më shumë familjet të cilët humbën të dashurit e tyre në këtë fatkeqësi. "Kam parë shumë dhimbje, por asgjë nuk mund të krahasohet me këtë tragjedi. Askush nuk di se cilat kanë qenë mendimet dhe fjalët e tyre të fundit. Askush nuk ka ditur se do ta humbë jetën e tij ditën e



djeshme. Dhimbja u mbetet atyre që përjetuan. Është tepër rëndë që ta kontrollojmë dhimbjen tonë. Nga kjo ditë zie të gjithë duhet të kuptojmë se jeta është e shkurtë. E lus Zotin që ti pranojë afër tij", tha Taravari.

Ai edhe njëherë shprehu ngushëllime për familjet që humbën të dashurit e tyre, ndërsa atyre që pësuan në aksident u dëshirojë shërim të shpejt. "Shumica për fat të mirë mbetën gjallë, tridhjetë tanimë po kurohen dhe nuk janë në rrezik jete. Sot ju themi lamtumirë 14 qytetarëve tanë, të cilët nuk arritën që të kthehen pranë familjeve të tyre dhe në shtëpitë e tyre", theksoi Taravari.

laruar familjari i Jeton Ismanit nga Gostivari.

NDIHMA E MADHE E BANORËVE TË LASKARCËS

Dëshmitarët okularë të kësaj tragjedie të madhe njerëzore, banorët e fshatit Laskarcë, të cilët edhe ishin të parët që ua dhanë ndihmën e parë viktimave, thonë se pas rrokullisjes së autobusit, fillimisht në qiell është ngritur pluhuri i madh dhe më pas kanë intervenuar. "Incidenti ka ndodhur në ora 17 fiks. Fillimisht ka pasur pluhur kur është rrokullisur autobusi. Të parët kanë vrapuar banorët e fshatit, të cilët kanë dhënë një

kontribut të jashtëzakonshëm. Njëherë i kemi nxjerrë nga autobusi personat që kanë bërë thirrje për ndihmë dhe të cilët kanë qenë poshtë autobusit, i kemi transferuar nëpër spitale me vetura private, në spitalin e Tetovës dhe '8 Shtatori' në Shkup dhe më pas ka ardhur Ndihma e Shpejtë, policia dhe zjarrfikësit, pra pas pas disa minutave. Ka qenë një situatë shumë e vështirë, të cilën nuk mund ta përshkruaj. Edhe pasi ka ardhur Ndihma e Shpejtë, ne së bashku kemi dhënë aq sa kemi mundur kontributin tonë që të dalim në ndihmë", thonë banorët e fshatit Laskarcë, të cilët siç shprehen

DO TË BËJMË ÇMOS QË TË ZBARDHIM SHKAQET E FATKEQËSISË

Humbja është e pariparueshme, por nuk jeni vetëm dhe nuk do t'u lëmë vetëm. Shpirtërisht jemi me ju, ndërsa do të jemi me ju edhe në të ardhmen. Marrim për detyrë të ndihmojmë familjet me atë që mundemi dhe do të angazhohem personalisht. Si Qeveri dhe organe kompetente, ju siguroj se do të bëjmë çmos të ndriçojmë arsyet e fatkeqësisë, ka thënë kryeministri Zoran Zaev në komemoracionin në Komunën e Gostivarit. Ai tha se dita e sotme dhe e nesërme janë ditë zie të gjithë vendin dhe lutjet e gjithë qytetarëve për ngushëllim




janë dërguar për secilin nga qytetarët që humbën jetën. "E ndaj dhembjen e madhe me ju. Na dhemb shpirti për secilin jetë të humbur. Ata janë edhe bashkëqytetarët tonë, janë fëmijë tanë, ishin shpresa jonë. Edhe pikëllimi është i përbashkët. Fjalët për ngushëllim në këto momente vështirë gjenden, pasi nuk ka ngushëllim për zemrat të cilët vajtojnë pas të dashurve të tyre. I vetëdijshëm se fjalët tani nuk mund të prekin deri të shpirti që mban zi", ka thënë Zaev gjatë fjalimit të tij.

SHOFERI I AUTOBUSIT LËSHOHET PËR MJEKIM NË SHTËPI

Shoferi i autobusit të kompanisë "Durmo Tours", që shkaktoi tragjedinë në autostradën Shkup-Tetovë, është lëshuar për mjekim në shtëpi, shkruan gazeta KOHA. Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe i shoqëruar nga kryeministri Zoran Zaev vizituan të lënduarit në spitalin "8 Shtatori", ndërsa tha se pas mjekimit, meqenëse nuk ka pasur lëndime të rënda, shoferi është liruar për kurim në shtëpi. Konfirmoi se që mbrëmë, meqenëse ka qenë në vetëdije të plotë, ai është marrë në pyetje nga pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në ndërkohe, ekspertiza e autobusit të dëmtuar të kompanisë "Duro Tours", i cili qarkullonte në relacion Shkup-Gostivar, do të realizohet në kazermën e Gjorçe Petrovskit.


ata, e kanë parë tmerrin me sy. Kardiokirurgu Ridvan Brajarami nga spitali "8 Shtatori", ka thënë se me të marrë lajmin për tragjedinë, organizimi i ekipi mjekësorë ka qenë shumë i shpejtë.

"Kemi qenë në mobilizim shumë të shpejtë, habitem dhe unë që në një mënyrë kaq të shpejtë të organizohemi sepse ndonjëherë nevojiten orë të tëra. Arsyet e vdekjes për viktimat do ti tregojë autopsia dhe mjeku ligjor, por të gjithë pacientet që janë pranuar në spitalin tonë janë shtruar për kurim, një pacientë është operuar dhe fatmirësisht pacientja është stabile", deklaroi Brajarami. Nga ana tjetër, Ilir Hasani, i cili është mjek në spitalin shtetërorë "Nënë Tereza", ka bërë të ditur se gruaja shtatzënë e cila ka qenë pjesë e aksidentit, është në gjendje të mirë shëndetësore dhe se e njëjta është transferuar në Gjinekologjinë e Shkupit për kontroll të mëtuqjeshëm. Sipas tij, disa nga pacientët - me vetë dëshirë kanë kërkuar që të lirohen nga spitali për shkak se gjendja e tyre shëndetësore ka qenë e mirë. Ndërsa një numër i madh i të aksidentuarve janë ende në spital duke e marrë trajtimin e nevojshëm mjekësor, ndërsa dy janë në gjendje kritike. ■




Xhes Bejli

Flamuri para ndërtesës së SHBA-së në Shkup dje ishte në gjysmë shtizë për aksidentin që ndodhi të mërkurën pasdite në autostradën Shkup-Tetovë, në të cilën jetën e humbën 14 persona, ndërsa ngushëllim për të pësuarit shprehu edhe ambasadori amerikan Xhes Bejli. "Jemi thellë të bindur për shkak të humbjes tragjike të jetëve në autostradën Shkup-Tetovë. Në emër të Ambasadës amerikane, dërgojmë ngushëllime të sinqerta deri te familjet e të vdekurve dhe deri te banorët e Gostivarit. Mendimet dhe lutjet tona janë me të lënduarit për rikuperimin e tyre të shpejtë".



Tomas Gerberih

Ambasadori i Gjermanisë në vend, Tomas Gerberih, dërgoi telegram ngushëllimi deri te kryeministri Zoran Zaev dhe ministri Venko Filipçe në të cilën shpreh ngushëllim të thellë deri te familjet e personave të vdekur në aksidentin që ndodhi në autostradën Shkup-Tetovë. "Më goditi thellë lajmi për aksidentin e rëndë të trafikut në autostradën Shkup-Tetovë që ndodhi dje. Ju dërgoj ngushëllime të thella në emër të Ambasadës së Gjermanisë, sidomos familjeve të viktimave", thuhet në telegramin e ambasadorit Gerberih.



Johanes Han

"Më vjen shumë keq për aksidentin tragjik që ndodhi mbrëmë në autstradën Shkup-Tetovë në Maqedoninë e Veriut. Mendimet tona janë me familjet dhe miqtë e viktimave dhe të lënduarve", shkruan në tuitin Komisari për Zgjerim dhe Politikë Fqinjësore, Johannes Han.

SHOFERI NUK KA QENË I DEHUR, AUTOBUSI MERRET PËR EKSPERTIZË

"Prokurori publik është njoftuar se analiza e kampioneve të gjakut dhe urinës ka treguar se në momentin e fatkeqësisë tek vozitësi nuk është regjistruar prani e alkoolit, medikamenteve apo substancave psikotropike. Me kërkesën e listingjeve nga operatori mobil do të konstatohet nëse vozitësi, në momentin e fatkeqësisë ka qenë duke e përdorur telefonin celular", thonë nga Prokuroria




Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 14 shkurt - Prokurori kompetent publik nga Prokuroria themelore publike Shkup, së bashku me ekipe të ekspertizës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dje e kreu ekspertizën në vendin e ngjarjes së fatkeqësisë së rëndë që ndodhi të mërkurën pasdite në autostradën Shkup-Tetovë, në të cilën 14 persona e humbën jetën, ndërsa shumë të tjerë janë të lënduar.

Nga Prokuroria publike informojnë se po punohet intensivisht në konstatimin e të gjitha hollësive që mund t'i zbulojnë shkaqet e fatkeqësisë. Duke pasur parasysh peshën e vetë ngjarjes dhe vëllimin e veprimeve hetimore që do të ndërmerren në procedurë paraprake gjatë veprimit rreth kësaj lënde është kyçur edhe prokurori i dytë

ERDOGANI NGUSHËLLON MAQEDONINË

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka shprehur ngushëllime për Maqedoninë e Veriut me rastin e aksidentit të djeshëm fatal në



autostradën Shkup-Tetovë, në të cilin humbën jetën 14 persona. Erdogan në një deklaratë është shprehur se e ka mësuar me

publik nga Prokuroria themelore publike Shkup.

"Autobusi i kompanisë 'Durmo Turs' që duke i kaluar dy korsitë e rrugës, doli nga autostrada dhe u rrokullis në afërsi të rrugës së vjetër, është ngritur nga vendi i fatkeqësisë dhe me urdhër të prokurorit publik ndaj tij do të

pikëllim të thellë lajmin për vdekjen e 14 personave dhe lëndimin e mbi 30 të tjerëve. Presidenti turk u ka shprehur ngushëllime familjarëve të viktimave të aksidentit dhe popullit të Maqedonisë së Veriut, duke uruar po ashtu shërim të shpejtë për të lënduarit.

kryhet ekspertizë e hollësishme teknike nga ana e Fakultetit të makinerisë në Shkup. Për shkak të konstatimit të drejtë të fakteve, sot në vendin e fatkeqësisë ishte i pranishëm edhe ekipi i Fakultetit të makinerisë, i cili i bëri kontrollet e para të gjendjes së automjetit. Nga njohuritë e


deritanishme është konstatuar se autobusi është marrë në vitin 2001, ndërsa për herë të fundit ishte regjistruar në janar të këtij viti. Me urdhër të prokurorit publik, Fakulteti i makinerisë do të përgatisë rezultat dhe mendim ekspertizë me shkrim", kumtoi Prokuroria. Në vendin e ngjarjes me prokurorin publik ishte i pranishëm edhe ekipi i Byrosë për ekspertizë gjyqësore, prej nga duhet të përgatitet rezultat dhe mendim ekspertizë me shkrim për shkaqet e fatkeqësisë.

Prokurori publik kompetent do ta kërkojë tërë dokumentacionin nga kompania "Durmo Turs" lidhur me lejet për transport publik që i posedon, mirëmbajtjen e automjeteve, numrin e udhëtarëve dhe biletat e shitura në autobusin që qarkullonte në relacionin Shkup-Tetovë, si dhe të dhëna lidhur me orarin dhe relacionet që i ka kaluar vozitësi në ditën kritike.

"Vozitësi i cili drejtonte autobusin është hospitalizuar dhe ka marrë lëndime trupore. Menjëherë pas fatkeqësisë, prokurori publik pati bisedë fillestare me të dhe me atë rast ai nuk dha të dhëna relevante për tërë ngjarjen.

Prokurori publik është njoftuar se analiza e kampioneve të gjakut dhe urinës ka treguar se në momentin e fatkeqësisë tek vozitësi nuk është regjistruar prani e alkoolit, medikamenteve apo substancave psikotropike. Me kërkesën e listingjeve nga operatori mobil do të konstatohet nëse vozitësi, në momentin e fatkeqësisë ka qenë duke e përdorur telefonin celular", thonë nga Prokuroria. Nga ana e ekipeve të ekspertizës të Ministrisë së Punëve të Brendshme pas ekspertizës së kryer, në Prokurorinë themelore publike Shkup do të parashtrohen procesverbalet për ekspertizë, skica, foto dokumentacioni dhe materiale të tjera të siguruar dëshmuere.

"Pas pranimit të këtyre dëshmimeve, pas parashtrimit të protokolleve të obduksionit, dokumentacionit mjekësor për lëndimet e udhëtarëve të tjerë, raportet për ekspertizat e ardhshme, pas marrjes në pyetje të vozitësit, udhëtarëve në autobus dhe dëshmitarëve okularë të ngjarjes, si dhe pas sigurimit të dokumentacionit të plotë relevant, varësisht nga faktet e konstatuara, prokuroria do të sjellë vendim", thonë nga Prokuroria. ■



Bojko Borisov

Kryeministri bullgar Bojko Borisov shfaqti keqardhje për viktimat në aksidentin e rëndë që të mërkurën pasdite ka ndodhur në autostradën Shkup-Tetovë. "Me dhimbje e dëgjova lajmin se në rrugën Shkup-Tetovë jetën e kanë humbur 14 persona. U shpreh keqardhje të afërmve të të vdekurve dhe u dëshiroj shërim të shpejtë të lënduarve", deklaroi Borisov.



Edi Rama

Kryeministri Edi Rama ka shprehur ngushëllime për viktimat e aksidentit tragjik në Maqedoni, ku humbën jetën 14 pasagjerë dhe mbetën të plagosur mbi 30 të tjerë, si pasojë e përmbysjes së një autobusi udhëtarësh në autostradën Shkup-Tetovë. Kreu i qeverisë shqiptare, shpreh solidaritetin e tij ndaj familjarëve të të ndjerëve, si dhe të plagosurve, duke theksuar njëkohësisht pikëllimin për tragjedinë e ndodhur në vendin mik, siç ai e quan. "Pikëllim për tragjedinë e autobusit në vendin fqinj të Maqedonisë së Veriut, ku numri i viktimave e të plagosurve ka tronditur e shqetësuar aq shumë familje. U jemi pranë shpirtërisht të gjitha familjeve dhe të gjithë vendit mik", shkruan Rama në rrjetin social Twitter.



Hashim Thaçi

"Ngushëllimet më të thella familjeve të viktimave të aksidentit në autostradën Shkup-Tetovë, ndërsa të lënduarve iu uroj shërim sa më të shpejtë dhe të plotë. Iu shpreh ngushëllime edhe udhëheqësve të institucioneve, si dhe tërë qytetarëve të Maqedonisë së Veriut", shprehet presidenti Hashim Thaçi, në statusin e tij në Fejsbuk.

ALEATËT E NATO-S SHPREHIN NGUSHËLLIME

Në fillim të ditës së dytë të takimit ministror të NATO-s për Mbrojtje, ministrja Radmilla Shekerinska ka pranuar ngushëllime prej kolegëve të saj prej vendeve anëtare, si edhe prej sekretarit të përgjithshëm, Jens Stoltenberg dhe përfaqësueses së lartë të BE-së, Federika Mogherini për të pësuarit në aksidentin tragjik në autostradën Shkup-Tetovë, njofton korrespondentja e MIA-s nga Brukseli. "Nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s përmes përfaqësueses së lartë për Politikë të Jashtme të BE-së, Mogherini kolegët e mi ministra të Mbrojtjes së SHBA-së, Gjermanisë, Sllovenisë, Holandës dhe Greqisë të gjithë në fillim i shprehën fjalët e njëjta ngushëlluese dhe shprehën keqardhje të thellë për

jetët e humbura. Kjo tregon se Aleanca e NATO-s nuk është vetëm aleancë ushtarake por edhe aleancë e shteteve që i ndajnë vlerat e njëjta por edhe të cilat janë së bashku në momente të vështira dhe të mira", deklaroi Shekerinska. Ministrja i përcolli edhe ngushëllimet personale për familjarët dhe të afërmit e viktimave në aksident. "Shpreh edhe ngushëllimin tim personal për familjet dhe të afërmit të cilët e humbën jetën në fatkeqësinë e autobusit dhe u dëshiroj rikuperim të shpejtë atyre të cilët akoma janë duke u trajtuar dhe të theksoj se sot patëm mundësi edhe në takimin e ministrave të Mbrojtjes të shohim se sa është e rëndësishme uniteti dhe solidariteti", thotë Shekerinska.

XHAFERI NË PARLAMENTIN SHQIPTAR

TIRANA VOTON PROTOKOLLIN PËR MAQEDONINË NË NATO

Në seancë fjalim mbajti edhe kryeministri Edi Rama, i cili lartë i vlerësoi marrëdhëniet mes dy vendeve dhe e theksoi mbështetjen e Tiranës për Shkupin.

Tiranë, 14 shkurt - Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, pas votimit të Protokollit për anëtarësimin e vendit në NATO në parlamentin shqiptar, me 130 vota "për" dhe asnjë "kundër", shfaqti falënderim të madh për mbështetjen që Shqipëria ia jep vendit. Xhaferi tha se Shkupi është përkushtuar në ndërtimin e një shoqërie për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, sociale apo çfarëdo tjetër.

"Punojmë shumë në drejtim të bërjes së reformave në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe ky proces nuk është aspak i lehtë por, synimi ynë është shtet me të vërtetë demokratik me sundim të të drejtës dhe me institucione funksionale në shërbim të qytetarëve, prandaj punojmë me përkushtim. Paraprakisht, u përqendruam maksimalisht në mbylljen e çështjeve që e ngarkonin rrugëtimin tonë kah arritja e përcaktimeve tona strategjike, gjegjësisht anëtarësimin e plotfuqishëm në NATO dhe BE. Nënshkruam Marrëveshje për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim me Republikën e Bullgarisë. Nënshkruam Marrëveshjen përfundimtare për zgjidhjen e kontestit rreth emrit me Republikën e Greqisë. Miratuam ndryshimet ku-



shtetuese, gjë që nuk ishte aspak e lehtë dhe shkaktoi protesta në të dyja anët, gjë që flet vetvetiu se Marrëveshja është një kompromis vin-vin, ku të gjithë janë fitimtarë dhe të gjithë janë humbës. Por, në fakt, fitoi largpamësia dhe guximi i shumicës parlamentare, fitoi vizioni për ardhmërinë e sigurt dhe fituan qytetarët tanë. E dinim ku duam të jemi dhe nuk hezituar në asnjë çast, pa dallim në vështirësitë, sepse qytetarët tanë meritojnë të jenë qytetarë të lumtur, me të drejta dhe liri të barabarta, me vlera dhe standarde evropiane, me mundësi dhe shanse të njëjta. Dhe, nuk ishim dhe nuk jemi vetëm në këtë rrugëtim. Çdoherë i kemi pasur pranë miqtë dhe partnerët e vërtetë dhe për këtë jemi mirënjohës pa masë", deklaroi Xhaferi.

Ai tha se shpreson se deri në fund të këtij viti apo në fillim të vitit 2020, Protokollin për anëtarësimin e plotfuqishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, që u nënshkrua ana e 29 ambasadorëve të shteteve anëtare, do të ratifikohet edhe në të gjitha 29 parlamentet nacionale, me Republikën e Maqedonisë së Veriut do të bëhet zyrtarisht anëtarja e 30-të. "Me ratifikimin e sotëm të Republikës së Shqipërisë dhe popullit shqiptar edhe njëherë e konfirmoi raportin miqësor ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ndaj qytetarëve të saj. Jeni të sigurt se ne këtë do e mbajmë mend gjithmonë, dhe gjithmonë kemi ditur t'i respektojmë dhe vlerësojmë miqtë tanë të vërtetë - Shqipëria dhe shqiptarët janë pikërisht kjo", theksoi Xhaferi. Në

seancë fjalim mbajti edhe kryeministri Edi Rama, i cili lartë i vlerësoi marrëdhëniet mes dy vendeve dhe e theksoi mbështetjen e Tiranës për Shkupin.

"Nuk mund ta fsheh kënaqësinë që ky moment ndeshet me një moment të artë në marrëdhëniet ndëretnike në vend, në çfarë shumica në pushtet luan rol të rëndësishëm. Pa shqiptarët nuk do të ekzistonte Republika e Maqedonisë së Veriut, ndërsa për Shqipërinë identiteti territorial i Maqedonisë së Veriut jo vetëm që është i paprekshëm, por dhe me rëndësi vitale dhe për të ardhmen tonë të tanihme dhe për të ardhmen, paqja dhe stabiliteti. Roli ynë në këtë proces historik ishte mbështetja. Gjendja e qetë është fillimisht meritë e liderëve politikë shqiptarë dhe të kryeministrit Zoran Zaev, të cilin e përshëndes", tha mes tjerash Rama. Megjithatë, seancën e la nën hije incidenti, kur deputeti të grupit të deputetëve të Partisë Demokratike opozitare Edi Paloka, njëherësh edhe nënkryetar i partisë, derdhi ngjyrë mbi kryeministrin Edi Rama, pas ishte larguar nga salla e Parlamentit.

Incident vijoi pasi kryeministri Rama, iu drejtua liderit të demokratëve Lulzim Basha, i cili më shumë foli për "krimin e Qeverisë" sesa për ratifikimin e Protokollit për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, duke thënë se "fëmija nuk e di çka bën dhe çka flet" se nuk është momenti as për shkak të tragjedisë në Maqedoni. Rama i kërkoi ndjesë kryetarit të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, i cili mori pjesë në seancë.



Guterresh e përshëndeti hyrjen në fuqi të emrit të ri

Shkup, 14 shkurt - Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterresh, e përshëndeti hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Prespës me të cilën u zgjidh kontesti shumëvjeçar midis Shkupit dhe Athinës. Guterresh e mori njoftimin zyrtar për ndryshimin e emrit të vendit në Republika e Maqedonisë së Veriut. Maqedonia dhe Greqia dorëzuan letër rreth përbashkët deri te sekretari i përgjithshëm i KB-së Guterresh, me të cilën e informojnë për datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutën 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për ndërprerjen e vlefshmërisë së Marrëveshjes së përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik midis të dyja palëve. "Guterresh të martën e mori njoftimin zyrtar për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Prespës, me të cilën mes tjerash është dakorduar emri i i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të pranuar nga të dyja palët", deklaroi dje zëdhënësi i Guterreshit, Stefan Dujsariq.

Ai përmendi se Guterreshi e përshëndet këtë zhvillim të ngjarjeve, me të cilin zgjidhet kontesti shumëvjeçar midis Shkupit dhe Athinës dhe i cili tregon se madje edhe se çështjet e ndjeshme mund të zgjidhen me dialog dhe vullnet politik. Sekretari i përgjithshëm i KB-së i ka uruar të dyja vendet dhe kryeministrat Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras për vendosmërinë e tyre në krijimin e vizionit të tyre për avancimin e marrëdhënieve mes të dyja vendeve, për edhe për stabilizimin e rajonit të Ballkanit. Guterresh i ka shfaqur falënderim ndërmjetësuesit Methju Nimic, për përkushtimin e tij gjatë negociatave. Njeriu i parë i KB-së u bëri thirrje vendeve-anëtare, organizatave rajonale dhe të gjitha partnerët ndërkombëtarë t'i mbështesin hapat historikë të cilat i kanë ndërmarrë të dyja vendet me zgjidhjen e kontestit.

Potenciali i bashkëpunimit Rusi-Maqedoni është i madh

Shkup, 14 shkurt - Duke shprehur ngushëllime për të pësuarit në aksidentin e komunikacionit në të cilin humbën jetën 14 persona, ambasadori rus Sergej Bazdnikin dhe e filloi fjalimin e rastit për ekspozitën e organizuar me rastin e 25 vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Federatës Ruse dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ai duke folur në gjuhën maqedonase, theksoi se historia e marrëdhënieve mes të dyja vendeve dhe popujve vëllazërorë nuk është vetëm shekulli i katërt por është shumë më i pasur dhe ka rrënjë të thella me lidhje shumëshekullore.

"Duke shikuar prapa në të ka-



luarën e para pak kohësh duket qartë se ka shumë punë për të cilat mund të përkujtohem dhe të krenohemi. Një numër i madh i planeve dhe projekteve tashmë janë realizuar. Në disa punë ndoshta kemi mundur edhe më shumë, por

asnjëherë nuk kemi imponuar asgjë, nuk jemi përzier në punët e brendshme e as nuk kemi për qëllim që ta bëjmë këtë në të ardhmen", tha ambasadori Bazdnikin. Ai nënvizoi se potenciali i bashkëpunimit Rusi-Maqedoni është

shumë i madh.

"Rusia angazhohet për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me Maqedoninë, por të afërt dhe intensiv për aq sa është e gatshme pala maqedonase për zgjerim të së njëjtës. Jam i bindur se zhvillimi i relacioneve bilaterale do t'i përgjigjet pritjeve të popujve të dy vendeve tona, në interesat e paqes, sigurisë dhe stabilitetit të Ballkanit, por edhe në gjithë Evropën", tha ambasadori rus, i cili bëri të ditur se pikërisht ai e ka përgatitur notën e vitit 1993 e cila kishte kishite arritur nga ish Republika e Maqedonisë për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike mes të dy vendeve.

MENAXHIMI I USHQIMIT TË TEPËRT

LIGJI QË DO TË "USHQENTE" TË VARFRIT

Në Maqedoni, mbi 400 mijë qytetarë nuk kanë mundësi të sigurojnë më shumë se një shujtë të ditë si rrjedhojë e varfërisë. Për këtë arsye, deri në muajin shtator do të zgjidhet në mënyrë ligjore problemi me tepicën e ushqimit që do të shkonte për qytetarët e varfër. Dëmi që shkaktohet nga hedhja e ushqimit shkon në 10 milionë euro



qedoni" thonë se dëmi që shkaktohet nga hedhja e ushqimit shkon në dhjetë milionë euro.

"Shifrat janë shumë serioze dhe është e pritshme që arrijnë edhe deri në 10 mijë tonë ushqime në vit, që si sasi mund të ndihmojë mjaft për kategoritë e prekshme sociale të qytetarëve. Andaj nisim një përkrah ndryshimet ligjore që parashikojnë lirim dhe bizneseve nga TVSH për ushqimin e dhuruar, procedura më të thjeshta dhe të shpejta për bizneset që nuk do të ngarkohen me burokracia e tepër të kështu me radhë. E gjithë kjo me qëllim që kompanitë të mos demotivohen të shpërndajnë ushqimin për nevojtarët", thonë nga "Ajde Maqedoni".

Nga organizata "Ajde Maqedoni" thonë se dëmi që shkaktohet nga hedhja e ushqimit shkon në dhjetë milion euro.

ÇKA THONË PËRVOJAT EVROPIANE?

"Në Francë, ku ekziston një mekanizëm ligjor që rregullon këtë çështje, dyqanet mund të nënshkruajnë marrëveshje me

ndonjë organizatë humanitare, nëse dëshirojnë, të lirohen nga teprica e ushqimit. Njëherazi të njëjtën nuk mund ta dërgojnë nëpër deponi. Kompanive në Francë më shumë ju shpaguehet të dhurojnë ushqimin, në vend se ta hedhin, për shkak se për këtë pasojnë edhe dënime", thotë Bllazhe Josifovski nga "Ajde Maqedoni".

Sipas tij, edhe përvojat italiane janë edhe më pozitive për shkak se sigurojnë subvencione, apo parashikohen edhe kompensime për organizatat joqeveritare që merren me këtë çështje.

Njëherazi edhe në programin për zgjedhjet e fundit parlamentare, nga LSDM kanë premtuar se në afat prej gjashtë muajsh do të miratojnë ligjin, të bazuar në përvojat e Francës, që do të mundësojë dhurimin e ushqimit nga ana e supermarketeve, restoranteve, prodhuesve dhe distributorëve.

Nga ana tjetër, njohësit e kësaj problematike thonë se miratimi i një Ligji të tillë, është mjaft i ndërlikuar për shkak se përputhen ingerencat e më shumë organeve dhe ministrive duke filluar nga

SHEMBULLI ITALIAN

Në muajin gusht të vitit 2016, Parlamenti italian miratoi një pako ligjesh që heqë pengesat për fermerët dhe detyron supermarketet që të dhurojnë për familjet në nevojë produktet e tyre. Qëllimi është parandalimi i humbjes së rreth 5 milionë ton ushqime, që shkojnë dëm çdo vit. Autoritetet italiane kanë ngritur shqetësimin se kjo humbje i kushton biznesit dhe familjeve më shumë se 12 miliardë euro në vit. Ligjet e reja kanë si synim krijimin e lehtësirave sa i përket dhurimit të ushqimit, duke i lejuar bizneseve që të dhurojnë në formë të thjeshtë për çdo muaj. Për këtë, qeveria italiane ka hequr sanksionet për ushqimet që u kishte kaluar data e shitjes, ndërsa pronarët e bizneseve, sa më shumë ushqime dhurojnë aq më pak taksa do të paguajnë për ushqimin e shkuar dëm.

Ligji për siguri të ushqimit që është nën kompetencën e Ministrisë së Bujqësisë, Ligjit për donacione që është nën kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë, lirim nga tatimet që është nën kompetencën e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve sociale...

Çështjet që duhet të zgjidhen në praktikë në aspektin ligjor janë procedurat se si do të veprohet me ushqim që ka afat të skaduar, por që megjithatë mund të konsumohet, si të veprohet me ushqimin që i afrohet afati i skadimit dhe mbetet i pa shitur, plotësimin e listës së ushqimeve që mund të dhurohen edhe pas skadimit të afatit, mbrojtjen e OJQ-ve nga ndjekja penale gjatë keqpërdorimeve apo fatkeqësive eventuale por vetëm në rast se në tërësi i respekttojnë rregullat për ushqim të sigurt. Njëherazi përvojat e jashtme tregojnë se i tërë procesi i donacionit të ushqimit kërkon edhe një rrjet të fuqishëm dhe mirë të organizuar, logjistikë të fuqishme, kushte për magazinimin e ushqimit, transport e kështu me radhë.

Në Francë para disa vitesh u aprovua një ligj, që e konsideron të paligjshme hedhjen e ushqimeve

nga supermarketet. Duke filluar nga korriku i vitit 2016, supermarketet në Francë nuk lejohen të hedhin ushqimet para datës së skadimit, por duhet t'ua dhurojnë të varfërve. Në Francë, supermarketet mund të gjobiten mbi 75 mijë euro nëse nuk firmosin një kontratë me qendrat e bamirësisë për të dhuruar ushqimin. Në Itali, gjithashtu ka kaluar një ligj, që rregullon shpërdorimin e ushqimit. Në muajin gusht të vitit 2016, Parlamenti italian miratoi një pako ligjesh që heqë pengesat për fermerët dhe detyron supermarketet që të dhurojnë për familjet në nevojë produktet e tyre. Qëllimi është parandalimi i humbjes së rreth 5 milionë ton ushqime, që shkojnë dëm çdo vit. Autoritetet italiane kanë ngritur shqetësimin se kjo humbje i kushton biznesit dhe familjeve më shumë se 12 miliardë euro në vit. Ligjet e reja kanë si synim krijimin e lehtësirave sa i përket dhurimit të ushqimit, duke i lejuar bizneseve që të dhurojnë në formë të thjeshtë për çdo muaj.

Për këtë, qeveria italiane ka hequr sanksionet për ushqimet që u kishte kaluar data e shitjes, ndërsa pronarët e bizneseve, sa më shumë ushqime dhurojnë aq më pak taksa do të paguajnë për ushqimin e shkuar dëm. Fermerët gjithashtu do të dhurojnë produktet e pa shitura për bamirësi, pa paguar ekstra. Sipas organizatës së OKB për ushqimin dhe agrikulturën, vetëm në Evropë përlogaritë që rreth 40 për qind e ushqimit shkon dëm. Sipas tyre, kjo sasi do të ushqente rreth 200 milionë njerëz.

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 14 shkurt - Maqedonia pritet që përfundimisht deri në muajin shtator të fitojë ligj që do të zgjidh problemin me tepicën e ushqimit që shpesh hidhet. Organizatat e ndryshme joqeveritare vite me radhë kërkojnë që në aspekt ligjor të zgjidhet kjo çështje, që prek më shumë palë në zinxhirin e prodhimit, përgatitjes dhe shitjes së ushqimit siç janë dyqanet, furnizuesit prodhuesit, restorantet si dhe amvisëritë.

Me ndryshimin e legjislacionit do të mundësohet që nga kjo tepicë e ushqimit së paku 13 mijë njerëz të fitojnë tre shujta në ditë. Në favor të miratimit të një ligji të tillë flasin edhe faktet se në Maqedoni bile 445 mijë qytetarë, nuk kanë mundësi të sigurojnë më shumë se një shujtë të ditë si rrjedhojë e varfërisë.

LIRIMIN I BIZNESEVE NGA TVSH PËR USHQIMIN E DHURUAR

Në funksion të përgatitjes së Ligjit për dhurimin e tepicës së ushqimit, Qeveria ka angazhuar Ministrinë e Bujqësisë që së bashku me Agjencinë për ushqim dhe veterinarin në një afat prej gjashtë muajsh të dalin me një draft version. Nga organizata "Ajde Ma-

KU ËSHTË MË LIRË, NË MAQEDONI APO NË GJERMANI?

Analiza e Institutit gjerman për shkencat e jetës në vendet evropiane që u publikua javën e shkuar shkaktoi një numër të polemikave në mediat sociale. Pretendohet se produktet bazë të bagëtive në Maqedoni janë ndër më të mirat në Evropë dhe se një ndryshim i tillë çon në konstatimin se një euro i fituar në Gjermani vlen dy herë më shumë në Maqedoni. Nga ky përfundim kanë filluar analizat e drejtpërdrejta

të çmimeve të produkteve bazë të kafshëve në Maqedoni dhe Gjermani. Analizat sugjerojnë se produktet në Maqedoni jo vetëm që janë më të lira, por janë të paktën të njëjtat çmime apo edhe më të shtrenjta se Gjermania e pasur. Pavarësisht dallimit të madh në standardet e jetesës dhe pagën mesatare, çmimet në Gjermani janë kryesisht të lira. Në Maqedoni më të lirat janë kripa, kafeja, pemë dhe perimet.

Investitorët nuk duan rritjen e pagës minimale!

Shkup, 14 shkurt - Delegacioni i ekonomisë gjermane në Maqedoni vlerëson se ligji i ri për rritjen e pagës minimale do të ndikojë negativisht ndaj atraktivitetit të Maqedonisë si lokacion për investim dhe se kompanitë do të përballen me shpenzime shtesë të cilat nuk janë paraparë me kohë në buxhetet e tyre.

Anketa e zbatuar nga Delega-

cioni i ekonomisë gjermane në Maqedoni ka treguar se për 15 për qind të kompanive të anketuara rritja në vlerë prej 10 për qind është e pranueshme, ndërsa 85 për qind kanë vlerësuar se Qeveria duhet t'i informojë 12 muaj më herët për rritjen ligjore të pagës minimale. 65 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se rritja nuk është marrë parasysh në buxhetin

për vitin 2019, duke pasur parasysh se nuk ishin informuar me kohë. "Rezultatet e fituara nga kjo anketë janë të rëndësishme së madhe për vendimet e mëtejshme për politikën tatimore dhe financiare e cila udhëhiqet tani, por edhe në të ardhmen në Maqedoni. Në fillim të këtij viti u votua ligji për rritjen e tatimit të të ardhurave prej 10 për qind në 18 për qind për

ata që marrin pagë më të lartë se 900 euro neto, nëse sillet edhe ligji për rritjen e pagës minimale, përsëri kompanitë do të përballen me shpenzime shtesë që nuk janë paraparë me kohë në buxhetet e tyre", theksojnë nga Delegacioni i ekonomisë gjermane në Maqedoni.

Anketa është zbatuar mes kompanive të Maqedonisë dhe të

huaja që kryejnë prodhimtari industriale. Në pyetjen se sa nga të punësuarit marrin pagë minimale, 90 për qind nga kompanitë e anketuara janë përgjigjur se vetëm ndërmjet një dhe 10 për qind nga të punësuarit marrin pagë minimale, për 40 për qind të kompanive rritja në vlerë prej tri deri në pesë për qind është e pranueshme.

Në programin afatgjatë për apartamente të destinuar për shitje, të shpallur nga AD për menaxhimin dhe ndërtimin e hapësirës banesore dhe zyra, janë planifikuar 58 ndërtesa me 4,140 shtëpi për Qytetin e Shkupit, qytetet dhe vendbanimet tjera

Koha Qefsere ABDYLI

Shkup, 14 shkurt - Në programin afatgjatë në ndërtimin e banesave për shitje për vitin 2019 parashikon, Qeveria ka planifikuar një zgjidhje të plotë në zonën e Cezarit, Ilinden. Shoqëria aksionare për ekonomizim me ndërtim të hapësirave banesore dhe afariste këtë vit do të fillojë të pastrojë terrenin për ndërtimin e rreth 1800 apartamenteve në tri ndërtesa në bllokun urban B2 në pjesën veriore të Kazermës Ilinden. Ndërtesa më e madhe do të ketë 1.058 banesa me një sipërfaqe prej 65.600 metra katror. Hapësira e garazhit ka një sipërfaqe totale prej rreth 66 mijë metra

QEVERIA ME ZGJIDHJE TË PLOTË NË ZONËN E CEZARIT NË KAZERMËN ILINDEN DO TË NDËRTOHEN 1800 APARTAMENTE



katrorë. Do të ketë edhe nëntë objekte të biznesit me përafërsisht 550.000 metra katrorë. Apartamentet e destinuar për shitje do të financohen plotësisht nga shitja e hapësirës banesore dhe zyra në ndërtim e sipër. Lokacionet janë siguruar në tokë në pronësi të Republikës së Maqedonisë, kurse dorëzimi i objekteve parashikohet të bëhet më së largu në vitin 2024. Në programin afatgjatë për apartamente të destinuar për shitje, të shpallur nga AD për menaxhimin dhe ndërtimin e hapësirës banesore dhe zyra, janë planifikuar 58 ndër-

tesa me 4,140 shtëpi për Qytetin e Shkupit, qytetet dhe vendbanimet tjera. Sipas numrit të banesave, objekti tjetër i planifikuar më i madh pas atyre në Kazernë Ilinden është Dovollegjik në Manastir me dy ndërtesa prej 134 pronave të patundshmërisë.

Kostoja totale e ndërtimit të hapësirës totale të destinuar për shitje është 37.7 miliardë denarë plus TVSH. Deri në fund të vitit 2018, investimet në këto objekte, që arrijnë në 13 milionë denarë, tashmë kanë filluar. Kristijan Trajkovski, drejtor i Shoqërisë aksionare për ekonomizim me

ndërtim të hapësirave banesore dhe afariste (SHAENHBA), njoftoi një tjetër rregullim gjatë verës dhe mundësisht vënien e "Ilindenit" në programin e vitit 2019. Mbetet e paqartë nëse projekti do të realizohet me një partneritet publiko-privat dhe në bashkëpunim me Komunën e Çairit. Kalimi në kazemat Ilinden me vendim të Qeverisë merret në programin vjetor për ndërtimin e një kompleksi biznesi me njësi banimi.

Ndryshe, në programin afatshkurtër për këtë vit janë planifikuar nëntë ndërtesa me më pak se 500 apartamente, dhe të njëjtat janë kryesisht ndërtesa në Karposh, Kisella Vodë dhe Qendër. 32 ndërtesa me rreth 1.700 apartamente janë planifikuar të ndërtohen për familjet e rrezikuara sociale, kryesisht në vendbanimet periferike. Për strehim individual ekzistojnë 18 objekte me 54 banesa në programin special.

Çmimet e banesave do të mbesin stabile

Shkup, 14 shkurt - Çmimet e banesave në Shkup, këtë vit do të mbesin stabile, por, përderisa vazhdon ngadalësimi i aktiviteteve ndërtimore pritet rritje e çmimit të hapësirës banesore në plan afatmesëm. Këtë e theksoi Vllatko Bogoevski, drejtor ekzekutiv i "Fortonmka", kompani konsultuese për patundshmëri komerciale, në prezantimin e sotëm të lëvizjeve të tregut të patundshmërive për vitin e kaluar, si dhe pritjet për vitin e ardhshëm. Bogoevski ka informuar se në territorin e qytetit të Shkupit, gjatë vitit 2018 janë dhënë 4.219 leje për ndërtim të njësisve banesore, prej të cilave numri më i madh 1.380 janë dhënë nga komuna Aerodrom, pas së cilës vijon komuna e Qendrës me 1.072 leje për ndërtim. "Sa i përket segmentit banesor, neto çmimi mesatar për metër katror në Shkup është më i lartë në komunën e Qendrës dhe arrin 1.062 euro në metër katror, ndërsa pastaj në komunën Karposh, 1.022 euro për metër katror. Më të kërkuara janë njësitë banesore me madhësi më të vogël, prej 36 deri në 52 metra katror, përkatësisht me madhësi prej 53 dhe 67 metra katror", tha Bogoevski. Nga kompania, tregun e hapësirës së zyrave e konsiderojnë stabil. Thonë se projektet e reja, që priten në vitin 2019 do ta rrisin ofertën e tërësishme të hapësirës së zyrave pothuajse për nëntë për qind, përkatësisht për 24.000 metra katror, por konsiderojnë se nuk do të ketë ndryshim të vlerës së qirave. Paralajmëruan se projekt më i madh në shtet dhe "new generation mall" do të jetë Skopje east gate, me neto sipërfaqe për qira prej 52.000 metra katror, që do të ndërtohet kah fundi i vitit 2020, ndërsa do të ofrojë hapësirë moderne të zyrave.

Publicitet

KOMUNA E BUTELIT

KRYETARI

nr. 09-313/2 nga data 13.02.2019

Shkup

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/2016, 64/2018 dhe 168/18), Kryetari i Komunës së Butelit publikon:

THIRRJE PUBLIKE për parashtrim të iniciativave për përpunim të Planeve urbanistike

Thirrja publike botohet në pajtim me nenin 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/2016, 64/2018 dhe 168/18), në tremujorin e parë të vitit 2019:

- Thirrja publike do të zgjat prej 19.02.2019 deri më 21.03.2019.
- Thirrja publike do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Butelit www.opstinabutel.gov.mk, në tabelën e shpalljeve të komunës, në sistemin informativ e-urbanizëm, në Fletën Zyrtare të Komunës së Butelit, në gazetatat ditore "Nova Makedonija" dhe "Koha".
- Çdo subjekt juridik dhe fizik i interesuar gjatë thirrjes publike mund të parashtrorë iniciativë për përpunim dhe sjellje të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alineja 2, 3 dhe 4 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik.
- Subjektet juridik dhe fizik të interesuar iniciativat mund t'i parashtrorë në formë të shkruar përmes arkivit të Komunës së Butelit ose në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm brenda afatit të lartpërmendur.
- Lëndë e iniciativës mund të jetë sjellja e planit të ri urbanistik ose ndryshimi dhe plotësimi i planit urbanistik ekzistues.
- Për iniciativat e dorëzuara parashtruesit do të njoftohen në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm ose në formë shkrimi, në afat prej 15 ditëve të punës pas përfundimit të afatit për parashtrim të iniciativave.
- Iniciativat e pranuar do të parashihen në Programin vjetor për përpunim të planeve urbanistike të Komunës së Butelit.

**KRYETARI I
KOMUNËS SË BUTELIT
Velimir Smilevski**

Ohër, tre automjete përfshihen në flakë

Tre automjete janë djegur në zjarrin që mbrëmë një orë pas mesnate ka shpërthyer në parkingun që ndodhet në hapësirën e ish Poligonit për sporte të vogla në qendër të Ohrit. Dy nga automjetet janë shkatërruar plotësisht, ndërsa një pjesërisht. Falë intervenimit të shpejtë të Shërbimit Zjarrfikës Territorial flakët e zjarrit për një kohë të shpejtë janë lokalizuar. Shkaqet për shpërthimin e zjarrit do t'i konfirmojë hetimi, por informacionet fillestare tregojnë se instalimi i dëmtuar nga një ndër automjetet e përfshira në flakë.

Tre të lënduar në 3 aksidente në Shkup

Shkup, 14 shkurt - Tre persona janë lënduar më lehtë në tre aksidente që kanë ndodhur gjatë 24 orëve të fundit në Qytetin e Shkupit. Në dy aksidente është shkaktuar dëm material. Sipas buletinit të SPB Shkup, janë evidencuar 14 shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, ndërsa nga trafiku janë përjashtuar shtatë shoferë të cilët kanë qenë nën ndikim të alkoolit, shtatë shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin para se ta marrin të drejtën e drejtimit të automjetit dhe katër shoferë fillestarë. Policia e trafikut ka përjashtuar nga trafiku edhe 14 automjete të parregjistruara. Në dritë të kuqe kanë kaluar shtatë shoferë, ndërsa 11 kanë përdorë celularë derisa kanë drejtuar automjetin, ndërsa pesë nuk kanë mbajtur rrip sigurimi. Gjatë 24 orëve të fundit janë lëshuar edhe 99 gjoba për parkim të parregullt, ndërsa me automjetin special "karrotrec" janë larguar 92 automjete.

Në Klinikën e Toksikologjisë, në vitin 2018 janë evidencuar gjithsej 424 persona me helmim akut nga alkooli

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 14 shkurt - Konsumimi i tepër dhe i përditshëm i alkoolit është arsyeja për rritjen e numrit të të sëmurëve, por edhe përkeqësimi të gjendjes ekonomike të shoqërisë në përgjithësi. Alkooli është shkak që mbi 200 persona janë shtrirë në spital. Përveç varësisë, personat që konsumojnë alkool me tepriçë, mund të ballafaqohen me cirrozë, kancer, por edhe me infeksione të tjera. Sipas informacioneve të drejtorit të Klinikës së Toksikologjisë, Nagip Zymberi, në qendrën informative të kësaj klinike, në vitin 2018 janë evidencuar gjithsej 424 persona me helmim akut me alkool. Në përputhje me informacionet e dhëna, psikologët mendojnë se alkooli është problem familjar dhe shoqëror, me përfshirje të madhe të komplikimeve psikologjike. "Alkoolikët shumë rrallë kërkojnë të zgjedhin problemet me anë të psikologëve ose psikiatrit. Për atë edhe vjen natyra e problemit, por edhe mungesa e shëndetësisë së duhur dhe trajtimi i rrjeteve sociale për parandalimin e këtij problemi", thotë psikologja Lidija Zorba. Stojan Meçev, kryetar i Klubit për trajtim të alkoolikëve thotë se një alkoolik përballet me shumë vështirësi, por shoqëria dhe trajtimet e ndryshme mund ta largojnë njeriun nga konsumimi i alkoolit.

"Anëtarët e këtij klubi më motivuan dhe më bindën të tërhiqesha

PROBLEMET E VARSHMËRISË NGA ALKOOLI

HOSPITALIZOHEN MBI 200 PERSONA



nga ky ves. Ata më bindën se jam në problem me alkoolin. Nëse nuk do të ishte ky klub, do të vazhdoja të njëjtën rrugë. Është rruga e ferrit. Është e vështirë të dilet nga ajo rrugë. Dihet se si duket një familje, kur ka një alkoolik në shtëpi, të gjithë vuajnë, si fëmijët edhe gruaja..", thotë Meçev.

Janë 3.600 qytetarë që kishin probleme me alkoolin dhe kanë kaluar nëpër klubin për trajtim të alkoolikëve. Aktualisht, klubi numëron 60 anëtarë. Anëtarët më i vjetër i klubit, Tashko Priçkov, thotë se shoqëria në këtë klub e ka përk-

rahur shumë në jetën e tij. "Mbështetja e shoqërisë në trajtimin e kësaj sëmundjeje të rrezikshme është varur nga ky klub, por edhe nga shoqëria jashtë", thotë Priçkov, ish alkoolik. Klubi aktualisht funksionon në baza vullnetare me tarifë mujore prej 50 denarë. Specialisti i psikologjisë mjekësore, Jovan Vleski, i cili punon si një terapist vullnetar në klub, thotë se shteti duhet të punësojë personel të përherëshëm në këto shoqata dhe t'i ndihmojë financiarisht. Kjo do ta shpëtojë shoqërinë dhe vetë shtetin. "Një ditë spitalore për një alkoolik

kushton 2,400 denarë. Nëse qëndron të paktën 2 javë, është rreth 30,000 denarë që do të financojë Fondi. Këtu vizita kushtojnë 50 denarë", thotë Jovan Veljski, specialist i psikologjisë mjekësore. Në katër dekada, në këtë klub janë shpëtuar shumë jetë. Nëse nuk ekzistonte, shumë familje do të shpërndahehin deri më tani, prandaj shteti dhe komunat duhet me çdo kusht t'i ndihmojnë, të varurve nga alkooli, të kenë një jetë normale. Mbështetja urgjente financiare për këto klube dhe punësimi i profesionistëve është i nevojshëm.

FORUM RAJONAL NË RAJONIN PLANOR TË SHKUPIT

Shkup, 14 shkurt - Qendra për zhvillim të Rajonit planor të Shkupit fillon me realizim të projektit "Zhvillim i qëndrueshëm dhe inkluziv i barabartë rajonal", që do të realizohet me mbështetje financiare të Konfederatës së Zvicrës Ambasadës së Zvicrës në Maqedoni, Agjencisë zviceriane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal.

Në kuadër të projektit do të zbatohet edhe programi "Forum rajonal në komunitet" me qëllim që të përforcohet pjesëmarrje civile në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe rajonal, të përmirësohen partneritetet mes subjekteve lokale dhe rajonale dhe të gjenden zgjidhje për problemet me interes për gjithë rajonin. Për rajonin planor të Shkupit është parashikuar grant prej 60.631 franga zvicerane. Ministri i Pushtetit Lokal, Suhejl Fazliu, kumtoi se shteti ynë është shembull i diferencave kryesisht të



mëdhë zhvillimore mes rajoneve planore, ndërsa akoma më shumë në kuadër të një komune, mes vendbanimeve urbane dhe rurale. "Qytetarët kanë të drejtë në qasje deri te shërbimet publike dhe kjo Qeveri ka bërë përpjekje maksimale që menjëherë në fillim të mandatit t'i ndërrojë gjërat. Për këtë vit për zhvillim të barabartë

janë ndarë shtatë milionë euro që është për 100 për qind më shumë në krahasim me vitin 2017. Vitin e kaluar me mjete nga ky program buxhetor janë realizuar 96 projekte në tetë rajone planore", theksoi Fazliu. Drejtuesi i Qendrës për zhvillim të Rajonit planor të Shkupit, Lupço Kec Micevski deklaroi se në sesionin e sotëm janë të pranishëm

kryetarë të komunave, sektori civil janë me qëllim, siç tha, të gjithë të japin kontribut të veti dhe pjesëmarrje në marrjen e prioriteteve. Paralajmëroi se ata si Qendër do të zbatojnë tre sesione nga këto forume dhe në fund, siç tha, do të dalim me një implementim të përbashkët të të gjitha nevojave që do të dalin nga këto forume.

Bota ka ende nevojë për NATO-n



Nga
Ursula von der LEYEN



Një NATO më e fortë, do t'i shërbejë interesave të sigurisë të të gjithë anëtarëve. Mbi të gjitha, ajo do të dërgonte një sinjal të qartë tek ata që e kundërshtojnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla: Ne aleatët transatlantikë, jemi të gatshëm të mbrojmë tokën, njerëzit dhe lirinë tonë

Në prill të këtij viti, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, do të festojë ditëlindjen e saj të 70-të. E themeluar në vitet e hershme të Luftës së Ftohtë, ajo është po aq e rëndësishme edhe sot, kur shumë njerëz mendojnë se rendi ndërkombëtar është tronditur sërish. Në fakt, nëse NATO nuk do të ekzistonte, ata që janë në favor të një bote të lire, do të duhej ta shpiknin atë. Ndërsa qëllimi kryesor i aleancës mbetet garantimi i sigurisë së anëtarëve të saj, ajo nuk ka qenë kurrë një aleancë e pastër ushtarake.

Ajo është gjithashtu një aleancë politike, bazuar në aspiratat e përbashkëta të anëtarëve të saj, të cilët siç e thotë Traktati i NATO-s "janë të vendosur të mbrojnë lirinë, trashëgiminë e përbashkët dhe qytetërimin e popujve të saj, bazuar në parimet e demokracisë, lirisë individuale dhe sundimit të ligjit". Sot këto parime, ndodhen nën një sulm. Agresioni rus në Evropën Lindore, sjellja agresive e Kinës në Detin e Kinës Jugore, terrorizmi i Shtetit Islamik, që përhapet nga Lindja e Mesme në kryeqytetet e Evropës, regjimet autoritare që zhvillojnë armë bërthamore - sfida këto të ndryshme, por që kanë një gjë të përbashkët: Ato lindin nga aktorë, që kundërshtojnë rendin aktual ndërkombëtar.

Ata përpiqen të minojnë, ose madje edhe të ndryshojnë rregullat, që kanë qeverisur epokën e demokracisë dhe prosperitetit, që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Për t'i tejkaluar këto sfida, demokracitë e NATO-s, duhet të qëndrojnë të bashkuara. Kolektivisht, ne jemi më të

fortë se sa do të ishte veçmas cilido prej nesh. Prandaj, që nga viti 2014, kur Rusia pushtoi Ukrainën, NATO është përshtatur me situatën në fjalë - siç ka bërë shumë herë gjatë historisë së saj. Në mesin e 29 shteteve sovranë, me kultura dhe pikëpamje të ndryshme politike, një përshtatje e tillë do të jetë gjithmonë e ndërlikuar dhe ndonjëherë kaotike.

Por aftësia e NATO-s për të ndryshuar prioritetet dhe strategjitë e saj, siguron që aleanca t'i qëndrojë provave të kohës. Dhe rezultatet janë të dukshme. Së pari, të gjithë anëtarët evropianë të NATO-s, i kanë rritur shpenzimet e tyre ushtarake. Për shembull, buxheti gjerman i mbrojtjes, është rritur me 36 për qind, krahasuar me kohën kur unë kam marrë

detyrën në fundin e vitit 2013. Ne ende kemi më shumë për të bërë, për të ndarë barrën në aleancë, dhe jemi të përgatitur të bëjmë më shumë. Por gjithashtu duhet të mos harrojmë, se ndarja e barrës nuk është vetëm për para, por edhe për aftësitë dhe kontributet. Gjermania është në këtë plan, kontribuesja e dytë më e madhe në NATO, dhe krenare që do

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribucioni: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte, 14 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

të udhëheqë Task Forcën e Përbashkët të NATO-s të Gati-shmërisë së Lartë. Ndërkohë, NATO ka rritur praninë e saj në Evropën Lindore, luan një rol aktiv në trajnimin e forcave irakiane të sigurisë, si dhe ndihmon në mbikëqyrjen e luftës kundër Shtetit Islamik, vazhdon të mbështesë qeverinë afgane, dhe zhvillon partneritetet e saj me vende që kanë një vizion të ngjashëm si Australia dhe Japonia, përveç shumë gjërave të tjera.

Në përbushjen e 3 detyrave të saj kryesore: mbrojtjes kolektive, menaxhimit të krizave dhe partneriteteve - aleanca është një gur i pazëvendësueshëm për një rend ndërkombëtar që favorizon lirinë dhe paqen. Mbi të gjitha, NATO nuk është një organizatë transatlantike vetëm në emër. Ajo përfaqëson një lidhje të veçantë, madje edhe emocionale midis kontinenteve amerikane dhe evropiane. Për një gjerman, imazhet e rënies së Murit të Berlinit, janë të lidhura ngushtë me aleancën, dhe vendi im është veçanërisht mirënjohës për sigurinë dhe mundësitë që NATO ka ofruar për dekada të tëra.

Pra, përveç përfitimeve praktike nga bazat, strukturave dhe trupat, NATO ka një vlerë në vetvete. Ndoshta përfitimimi më themelor i NATO-s, është se ajo siguron besueshmëri në një botë të pasigurt. Angazhimi ynë i patundur ndaj nenit 5, dispozita e mbrojtjes kolektive të traktatit të NATO-s, bën që siguria jonë e përbashkët të jetë vërtet e pandashme. Ne do të ndihmojmë aleatin tonë më të dobët, ashtu siç kemi ndihmuar më të fuqishmit duke iu referuar nenit 5 - për herë të parë dhe të vetme në historinë e NATO-s - pas 11 shtatorit 2001. Pra, është mirë diçka e mirë që Bashkimi Evropian, po ndërmerr hapa të rëndësishëm për të rritur aftësitë e tij ushtarake.

Nëse anëtarët e unionit arrijnë të harmonizojnë strategjitë e tyre të mbrojtjes dhe përgatitjes ushtarake, dhe duke i ndërthurur forcat e tyre të armatosura, atëherë e gjitha kjo do të shtojë forcën e NATO-s. Dhe një NATO më e fortë, do t'i shërbejë interesave të sigurisë të të gjithë anëtarëve. Mbi të gjitha, ajo do të dërgonte një sinjal të qartë tek ata që e kundërshtojnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla: Ne aleatët transatlantikë, jemi të gatshëm të mbrojmë tokën, njerëzit dhe lirinë tonë. (Nju Jork Tajms)

Shënim: Ursula von der Leyen, është ministre e Mbrojtjes e Gjermanisë

Kriza e Kosovës dhe zgjidhja që duket ende e largët



Nga
Thomas BREY

Si këto ditë 20 vjet më parë, në Rambouillet të Francës filloi konferenca ndërkombëtare e paqes për konfliktin që zgjaste disa dekada midis Serbisë dhe Kosovës, të banuar nga shqiptarët. Beogradi nuk pranonte asnjë propozim që i prezantohej. Më 24 mars 1999, NATO filloi ndërhyrjen ushtarake, të parën ndërhyrje gjatë ekzistencës së saj. Bombat e NATO detyruan ushtrinë serbe dhe shumë njësi paramilitare, që të tërhiqeshin nga Kosova, pasi kishin detyruar dëbimin e 800 mijë shqiptarëve. Që prej asaj kohe, Kosova, e cila u bë më 2008 shteti më i ri i Europës dhe u nda nga Serbia, u vendos pak a shumë nën vëzhgimin ndërkombëtar. Trupa mbrojtëse e Kosovës, e drejtuar nga NATO, KFOR-i, u bë garanci për sigurinë. BE u përpoq për dhjetë vjet me radhë, që të formonte me misionin e saj më të madh jashtë BE-së, EULEX-in, një shtet juridik demokratik.

GJENDJA

Kosova vazhdon të jetë një nga shtetet më të korruptuara. Mediat dhe drejtësia kanë ngelur varur në klanet e politikës. Kontrabanda e armëve, drogës dhe qenieve njerëzore janë „sektorët ekonomikë” më të rëndësishëm. Papunësia është e madhe. Kush ka mundësi të largohet migron në Europën Perëndimore. Në Serbi gjendja është e njëjtë, megjithëse vendi është zyrtarisht kandidat për t'u pranuar në BE. Komisioni i BE-së, ka parashikuar madje vitin 2025, si datë e mundshme pranimi. Megjithëse BE është duke ndërmjetësuar prej vitesh midis fqinjëve të armiqësuar, përparime për qetësimin e konfliktit të vazhdueshëm nuk janë bërë. Parlamenti serb sapo u



Ka 20 vjet që “kriza e Kosovës” shfaqet në titujt e gazetave. Gjendja e staus quo-së ngjan më shumë me një paqe të bllokuar se sa me një paqe të vërtetë. Një prezantim i fakteve

tall me BE-në, duke e quajtur „tigër pa dhëmbë”.

Pse nuk janë duke u arritur përparime në këtë krizë, megjithëse SHBA dhe BE kanë vënë në dispozicion ushtri me diplomatë dhe ekspertë, si dhe miliarda euro? Gjendja është ashpërsuar madje javët e fundit. Linjat e bisedave midis Beogradit dhe Prishtinës janë shumë larg njëra-tjetrës.

Shqiptarët e Kosovës kanë marrë vendim të krijojnë ushtrinë e tyre. Reagimet e Serbisë luhaten midis indinjatës dhe mungesës së fuqisë. Prishtina vuri taksa 100 për qind për mallrat serbe, sepse Beogradi nuk do që ta njohë Kosovën, nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare. Dëmet ekonomike të Serbisë vlerësohen mbi 100 milionë euro. Javën e kaluar, parlamenti i Kosovës nxori ligjin që e bën minierën e Trepçës kombëtare, megjithëse kjo sipërmarrje e rëndësishme është prej kohësh një pikë e diskutueshme midis dy vendeve fqinje.

PJESA VERIORE E MITROVICËS

Ekzistojnë disa pengesa të rëndësishme, që e pengojnë zgjidhjen e krizës së Kosovës. Sepse praktikisht askush nuk ka interes në zbutjen e shpejtë dhe

afatgjatë të konfliktit. Presidenti i gjithëpushtetshëm serb, Aleksandar Vuçiç, është një aktor shumë i mirë. Nuk dihet nëse ai është po aq i apasionuar me shahun sa kolegu i tij rus, Vladimir Putin. Sidoqoftë, të dy politikanët e nivelit të lartë janë mjeshtra taktike në shahun politik të Ballkanit.

Sipas studimeve të fundit ka dalë se Moskë nuk ka interes që t'i japë një përgjigje përfundimtare çështjes së Kosovës. Sepse nëse do ta bënte do të humbiste ndikimin në rajon. Prandaj pengon me veton e saj Këshillin e Sigurimit të OKB, që të marrë vendime për Kosovën, kundër interesave të aleatit të ngushtë, Serbisë. Dhe kështu qëndron e lidhur ngushtë me Serbinë, si vendin më të madh dhe më të rëndësishëm të Ballkanit Perëndimor.

SERBIA

Vuçiçi i Serbisë është rritur me temën e Kosovës. Fillimisht ai ka qenë një nga mbështetësit e partisë së Sllobodan Millosheviçit, që vdiq në Hagë, në Gjykatën ndërkombëtare për krimet e luftës, dhe që iu ngarkuan luftërat që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë. Vuçiçi ka shtatë vjet që qëndron në pushtet. Kjo falë premtimeve që i ka bërë Berlinit, Uashingtonit dhe Brukselit se do të punojë për një zgjidhje në çështjen e Kosovës. Për këtë Perëndimi i la dorë të lirë në politikën e brendshme. Askush nuk ka ushtruar kritika të ashpra që Vuçiçi ka ndërtuar një sistem autokratik pushteti. Nëse presidenti i jep vërtet fund konfliktit të Kosovës, atëherë ai nuk do trajtohej më në mënyrë speciale nga Perëndimi. Vuçiçi do të duhej të merrej me kritikën për mosrespektimin e institucioneve demokra-

tike si dhe vënin nën kontroll të drejtësisë dhe mediave. Përveç kësaj, sipas të dhënave të veta, Beogradi i jep çdo vit 500 milionë euro pakicës serbe në Kosovë. Paratë administrohen pa kontrollin e askujt. Kështu që gjithnjë mund të mбетet diçka për xhepat e veta.

KOSOVA

Edhe në Kosovë udhëheqësit politikë nuk janë të interesuar në ndonjë paqe afatgjatë me fqinjin, Serbinë. Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj janë rritur në luftën e armatosur kundër Serbisë. Edhe sot ata marrin simpatinë nga populli nëpërmjet antiserbizmit. Si në Serbi ashtu edhe në Kosovë, opozita është shumë më radikale se sa qeveritarët. Në Beograd opozita nacionaliste akuzon Vuçiçin për tradhti kombëtare, për shkak të gatishmërisë për bisedime me Prishtinën. Partia opozitare nacionaliste në Kosovë, Vetëvendosje, do donte që sot të ndërpriste çdo lloj kontakti me Serbinë, derisa parësia të njihej nga Beogradi.

VËSHTRIM

SHBA ka nën presidentin Donald Trump probleme krejt të tjera botërore, që e lënë Ballkanin mënjanë. BE duket se e ka ulur angazhimin, pas shumë proceseve të pasuksesshme ndërmjetësimi. Askush nuk beson se duke pasur parasysh zgjedhjet për Parlamentin Europian në maj, e ngarkuara me politikën e Jashtme të BE, Federica Mogherini, do të përdorë gjithë fuqinë që ka për të ofruar një zgjidhje të konfliktit të Kosovës. Çdo gjë tregon për ngrirjen e konfliktit të Kosovës. Kjo gjendje nuk e minimizon rrezikun e konflikteve të dhunshme. (DW)



Nevoja për të pastruar, tani më shumë e ndjerë, në shekullin XIX i dha gjithashtu një shtytje të madhe zhvillimit të teknologjisë. Pastruesi i parë i mekanizuar i rrugëve, u patentua nga inxhinieri Xhozef Uituorth nga Mançesteri në 1843: ai tërhoqej nga kuajt. Në Shtetet e Bashkuara, pastruesi i parë mekanik i rrugëve u patentua më 1849 nga C.S Bishop. Me pak fjalë, pastrimi i rrugëve në Perëndim, është një zhvillim i dekadave të fundit



PASTRIMI I RRUGËVE:

HISTORIA E NJË ZAKONI TË DEKADAVE TË FUNDIT



Kur mediat shfaqin imazhet e një rrugë të pushtuar nga plehrat, reagimi ynë i natyreshëm është bezdia. Ideja e një qyteti të pistë, nuk na lë indiferentë, dhe ka edhe ata që e shohin pastrimin e trotua-reve, si një tregues të qeverisjes së mirë: nëse pislëku përmyt trotua-ret, atëherë diçka në qeverisje çalon. Por a ka qenë gjithmonë kështu? Pse i kushtojmë shumë vëmendje pastrimit të rrugëve? Dhe që kur? Historianët besojnë se ideja e pastrimit të rrugëve, ka lindur rastësisht, dhe efektet e tij të dobishme nuk ishin parashikuar. Në fakt, deri në përhapjen e Mur-tajës (viti 1348), ishte e zakonshme hedhja jo vetëm e mbeturinave, por edhe jashtëqitjes në rrugë. Rrugët qenë sigurisht shumë ndryshe nga ato që janë sot, dhe u ngjanin më shumë rrugëve në fshat, ku burrat dhe kafshët jetonin së bashku, duke pritur që shiu apo vetë kafshët, sidomos derrat, të pastro-nin mbeturinat.

NJË ZAKON I NISUR NË SHEKULLIN XIX

Vala e parë e dëshirës për pa-stërti daton në vitet 1300. Në fillim të shekullit, në Siena të Italisë, u shpall një garë publike për mbledhësin e "të gjitha mbeturina-ve, plehut organik dhe gurëve në sheshin Kampo, dhe rrugët aty

pranë". Dimë gjithashtu se në vitin 1349, mbreti Eduardi III i Angli-së, i shkroi një letër kryebashkiakut të Londrës, duke u ankuar se rrugët ishin shumë të pista, duke besuar se era e jashtëqitjeve njerëzore ndikonte në përhapjen e Mur-tajës. Pra, për herë të parë në Angli u vendos një dënim për këdo që ka-pej duke hedhur jashtëqitjet njerë-zore në rrugë, dhe kjo i detyroi njerëzit të hiqnin të paktën mbeturinat e tyre nga rrugët. Sipas disa historianëve, ishte mur-taja ajo që i nxiti paraardhësit tanë të fillonin pastrimin e rrugëve. Por për të parë rrugë vërtet të pastra, do të duhej të kalonin disa shekuj.

NJU JORK, NJU JORK

Për më tepër, jo e gjithë bota zbuloi në të njëjtën kohë praktikën e higjienës publike. Në SHBA, ku sot rrezikoni të gjobiteni rëndë, edhe nëse hidhni përtokë një bi-sht cigareje, ideja e pastrimit të rrugëve është e kohëve të fundit. Dejvid Rozner, profesor i historisë dhe shëndetit publik dhe mjekësi-së në Shkollën e Shëndetit Publik në Universitetin e Kolumbia, shkruan në portretin e tij mbi Nju Jorkun e vitit 1800: "Qyteti i Nju Jorkut, ishte personifikimi i një qy-teti në krizë gjatë shekullit XIX-të. Nga një qytet i vogël prej rreth 30 mijë banorësh në vitin 1800, Nju

Jorku nisi ta dyfishojë madhësinë e tij çdo 10 vjet. Në fillim të shekullit XX-të, popullsia arriti në 4 milionë. Kjo mbingarkesë e pabesueshme njerëzore, e kombinuar me një in-frastrukturë primitive, krijoi kushtet ideale për një rritje dramatike të sëmundjeve epidemike. Qyteti relativisht i shëndetshëm i vitit 1800, përjetoj një sulm të së-mundjeve infektive, si kolera, ethet tifoide, tifoja, ethet e verdha, ma-laria dhe sëmundjet e tjera të tran-smetuara nga mushkonjat. Shkal-la e vdekshmërisë në qytet u rrit, dhe shumë fëmijët vdiqën. Qyteti dukej se po rënohej". Në fillim të shekullit XIX-të, në qytet jetonin 100-200 mijë kuaj. Secili prej tyre prodhonte më shumë se 10 kg pleh organik dhe disa litra urinë në ditë. Kuajt, derrat, delet dhe bagëtitë, ishin të gjitha pjesë e jetës së përditshme me derrat që shëtisnin rregullisht në tufa.

TAKAT E DOBISHME

Në këtë fazë të historisë, në shumë qytete evropiane dhe ame-rikane mungonte jo vetëm pastër-tia në rrugë, por nuk ishin marrë as masa të tjera minimale higjienike. Mbeturina, duke përfshirë edhe ja-shtëqitjet e njeriut hidheshin nga dritaret. Ironikisht kjo ndikoi në zhvillimin e modës. Zotërinjtë vi-shnin këpucë me taka të larta, për

të mbrojtur pantallonat e tyre të gjata nga pislëku, dhe kapele me strehë të madhe për të mbrojtur kokat e tyre nga jashtëqitjet që fluturonin nga dritaret e katit të dytë. Zonjat ecnin pranë godinave, dhe kishin më pak gjasa për të pasur ndonjë surprizë të pakëndshme. Sëmundje të tilla si mur-taja bubo-nike, kolera dhe tifoja ata ishin aq të përhapura, sa që popujt evropianë u gjymtuan ndjeshëm (25-30 për qind e popullsisë vdiq).

KUTËRBIMI I MADH

Në Londër, vitet 1858-1859, kuj-tohen si ato të Kutërbimit të Madh. Edhe Parisi nuk ishte më mirë në menaxhimin e mbeturinave. Filozofi kanadez, Xhon Ralston Saul shkroi në librin "Bastardët e Volte-rit: Diktatura e arsyes në Perëndim": "Sistemi i famshëm i kanali-zimeve në Paris, u ndërta gjatë një periudhe të gjatë kohore, në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Vonesat e mëdha, ishin kryesisht për shkak të kundërshtimit të fortë të pronarëve, të cilët nuk donin të paguanin për të instaluar tuba sa-nitare në shtëpitë e tyre. Prefekti i Parisit, zoti Pubel, arriti t'i detyrojë pronarët më 1887, vetëm pas një beteje të ashpër publike..."

Më 1910, pak më shumë se gjy-sma e ndërtesave të qytetit, ishin përfshirë në sistemin e ujërave të

zeza, dhe vetëm gjysma e qyteteve në Francë kishte një të tillë. Pastaj, kur shkencëtarët zbuluan lidhjen mes sëmundjes, ujit të ndotur dhe papastërtisë, kanalet e hapura u zhdukën, dhe u futën gradualisht sistemet moderne të kanalizime-ve. Por si dhe kur filloi pastrimi i rrugëve? Të dhënat e qytetit të Lon-drës më 1863, tregojnë një kërkesë publike për pastrues për të pa-struar papastërtitë, dheun dhe pluhurin nga rrugët e qytetit. Të varfrit ishin të parët që u morën me këtë punë: të "armatosur" me një lopatë dhe një fshesë, ata ecnin lart e poshtë nëpër rrugë, duke pa-struar sa të mundeshin.

Por nevoja për të pastruar, tani më shumë e ndjerë, në shekullin XIX i dha gjithashtu një shtytje të madhe zhvillimit të teknologjisë. Pastruesi i parë i mekanizuar i rrugëve, u patentua nga inxhinieri Xhozef Uituorth nga Mançesteri në 1843: ai tërhoqej nga kuajt. Në Shtetet e Bashkuara, pastruesi i parë mekanik i rrugëve u patentua më 1849 nga C.S Bishop.

Me pak fjalë, pastrimi i rrugëve në Perëndim, është një zhvillim i dekadave të fundit: një arritje e viteve 1900 që u zgjerua paralelisht me ndërgjegjësimin mjedisor të viteve 1970, kur qeveritë filluan të tregonin shqetësim për cilësinë e ujërave. (Focus)

Sot në Ferizaj bashkëjetesa fetare është një shembull për të gjithë. Besimtarët e të dy anëve nuk kanë asnjë problem mes vete, dhe kështu e bëjnë këtë oborr të vetmin në Evropë, shumë kurioz dhe tërheqës për ta parë nga afër. Kisha dhe xhamia janë shënjestra kulturore e Kosovës, për shumë studentë e turistë të huaj, të cilët magjepsen me bashkëjetesën dhe tolerancën fetare mes tyre

FERIZAJI, VATRA E FENOMENEVE QË PO MAHNIT GJITHË EVROPËN



Ferizaj, qyteti i krijuar më së voni në Kosovë, që kur është ndërtuar stacioni hekurudhorë në vitin 1873. Ky qytet është i vendosur në pjesën jugore të Kosovës me një popullsi mbi 108.690 banorë. Ky qytet karakterizohet nga dy fenomene të jashtëzakonshme, të cilat janë të vetmet në Evropë, dhe si degë e Kosovës gjenden në Ferizaj. Bifurkacioni dhe toleranca fetare, e përshkruan më së mirë gjeografinë dhe historinë e këtij vendi, të kërkuar nga shumë studiues e turistë.

Bifurkacioni në qytetin e Ferizajt, respektivisht Bifurkacioni i lumit Nerodime është një fenomen natyror i ndarjes së lumit në dy degë dhe derdhjes në dy dete. Ndërsa një tjetër fenomen shumë i rëndësishëm dhe i vetëm poashtu në Evropë, janë edhe objektet e

dy besimeve fetare në një oborr, në qendër të qytetit.

KISHA DHE XHAMIA

Kisha Ortodokse dhe Xhamia në Ferizaj janë në një oborr mbi 80 vjet. Historia e kësaj ngjarje nuk është e pastër siç është sot toleranca mes vete të ferizajasve, pasi ndërtimi i kishës nuk është bërë me dëshirë të muslimanëve. Në fillim ka qenë vetëm xhamia në atë pjesë, mirëpo gjatë viteve 1928, serbët e morën me dhunë një pjesë të oborrit të xhamisë, dhe e ndërtuan kishën. Duke e njohur regjimin serb, ishte e pamundur të kundërshtohet kjo edhe pse atë kohë nuk ka qenë aspak e mirëseardhur për besimtarët muslimanë, mirëpo nuk janë pyetur fare

rreth kësaj teme.

Për dallim nga ajo kohë, sot në Ferizaj bashkëjetesa fetare është një shembull për të gjithë. Besimtarët e të dy anëve nuk kanë asnjë problem mes vete, dhe kështu e bëjnë këtë oborr të vetmin në Evropë, shumë kurioz dhe tërheqës për ta parë nga afër. Kisha dhe xhamia janë shënjestra kulturore e Kosovës, për shumë studentë e turistë të huaj, të cilët magjepsen me bashkëjetesën dhe tolerancën fetare mes tyre.

BIFURKACIONI

Lumi i Nerodimës buron në Bjeshkët e Jezercit, (një fshat në afërsi të Ferizajt) dhe ndahet pakthyeshem në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndrysh-

me. Dega veriore derdhet në lumin Sitnicë dhe vazhdon rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, ndërsa ajo jugore përmes lumit Lepenc dhe Vardarit derdhet në Detin Egje, shkruan Gazeta Metro.

Kjo dukuri është e rrallë jo vetëm në trojet tona por edhe jashtë kufijve, duke u cilësuar si fenomeni i vetëm në Evropë. "Bifurkacioni" sot në Ferizaj shfrytëzohet edhe si vend pushi-

mi, pasi ka shumë vizitorë nga e gjithë Kosova dhe më gjerë, vijnë për ta shijuar nga afër këtë vend shumë interesant i cili ka rëndësi të madhe edukativo-arsimore, shkencore dhe turistike. Madje është vizituar nga shumë studiues, gjeograf, historian, hidrolog, gjeolog etj. Bifurkacioni i lumit Nerodime nga viti 1979 është vënë nën mbrojtje ligjore si rezervat special i natyrës. Sipërfaqja e tij e mbrojtur është 12.78 ha. (gazeta metro)



Italia do të zhytet në det deri në vitin 2100

Agjencia kombëtare italiane për teknologjitë e reja dhe energji, ka parashikuar se Italia do të zhytet në det deri në vitin 2100. ENEA, në kuadër të një konference për zhvillim e qëndrueshëm, shfaqti disa parashikime për ngritjen e shpejtë të Mesdheut, kjo për shkak të ngrohjes globale. "Mijëra kilometra katrorë të zonave bregdetare rrezikojnë të zhduken në mungesë të ndërhyrjeve zbutëse dhe adaptimit", thuhet në njoftimin e agjencisë. Sipas ENEA-s, deri në fund të shekullit, rritja e nivelit të detit përgjatë brigjeve italiane, vlerësohet mes 0.94 dhe 1.035 metra. Këto vlerësime janë bërë duke marrë parasysh një model paraprak minimal dhe "mes 1.31 dhe 1.45 metra", duke ndjekur një bazë më pak të kujdesshme.

Shqipëria, shteti i dytë më i padobishëm në Evropë

Në një klasifikim të 153 shteteve të botës sipas kontributit të gjithsecilit në zhvillimin dhe të mirën e njerëzimit, Shqipëria renditet e 70-ta, nga vendi i 69-të i një viti më parë. Pra, Shqipëria është vendi i parafundit në Europë, çka do të thotë se, është shteti european më "i padobishëm" pas Ukrainës dhe se ka kontributin më të vogël në zhvillimin e njerëzimit.

Indeksi i "vendeve të mira" përpilohet mbi bazën e kriterëve si: Shkencën dhe Teknologjinë, kulturën, paqjen, rendin botëror, klimën, barazinë, shëndetin dhe mirëqenien. Ndër to, padiskutim që ajo që i referohet shëndetit dhe prosperitetit është një njollë e zezë, pasi në renditje në vendin e 142-të në botë, ndër 153 shtete, madje edhe më keq se vende mjaft të pazhvilluara të Afrikës, Amerikës Latine apo edhe Azisë Jug-lindore. Kjo performancë e dobët vjen si rrjedhojë e nën-indikatorit që i referohet ndihmës humanitare dhe donacioneve. Një tjetër indikator që na rendit ndër vendet e fundit në botë është ai



që i referohet shkencës dhe teknologjisë.

Në këtë drejtim, Shqipëria është e 119-ta në botë, në rënie të ndjeshme në krahasim me vitin paraardhës. Indikatorët që kanë një vlerësim pozitiv ndërkohë janë ata që i referohen prosperitetit dhe barazisë si dhe ai i kulturës. Pra, në drejtim të kulturës, Sh-

qipëria renditet e 54-ta në botë, Të paktën në këtë drejtim vlerësohet si një shtet që i jep diçka njerëzimit, madje edhe më shumë se Rusia, Turqia, Kina, etj. Në nivel global, kurorën e shtetit më të mirë e merr Finlanda, që ndiqet nga Irlanda dhe Suedia, ndërkohë që në vend të fundit renditet Iraku me Libinë dhe Jemenin.



Kërkohet centralizimi i arsimit dhe zvogëlimi i paraleleve në Kosovë

Gjatë dekadës së fundit në Kosovë është zvogëluar numri i nxënësve për 20 për qind, derisa ai i punëtorëve të arsimit është rritur 8 për qind.

Kështu ka thënë eksperti i arsimit, Dukagjin Pupovci, gjatë tryezës për menaxhimin e sistemit arsimor, organizuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, gjatë së cilës u propozua centralizimi i arsimit, si dhe mbyllja e disa shkollave që funksionojnë si paralele.

Eksperti i arsimit, Pupovci tha se çdo vit në Kosovë në klasat e para ka 500 deri në 1000 nxënës më pak.

Pupovci, që është njëherësh drejtor në Qendrën për Arsim të Kosovës, po ashtu tha se shumica e subjekteve politike në Kosovë kultivojnë një kulturë klienteliste, duke punësuar bashkëpartiakët e tyre. Ai po ashtu tha se në Kosovë ka një numër të konsiderueshëm të paraleleve, të cilat kanë më shumë staf arsimor se sa nxënës.

Ndërkaq, nga GIZ-i gjerman ishte i pranishëm Boris Scharlowski, i cili tha se gjatë viteve të fundit, GIZ ndër të tjerash ka trajnuar rreth 1000 drejtorë, rreth 5000 mësimdhënës dhe ka formuar komunitetet e të mësuarit së bashku në Kosovë. Sipas tij, ligjet dhe planet e arsimit në Kosovë duhet të zbatohen.

Deputetja nga radhët e Vetëvendosjes, Arbërie Nagavci tha se Vetëvendosje ka paraparë katër tryeza diskutimi kushtuar arsimit parauniversitar.

Nga LVV kanë njoftuar se do të mbahen edhe tri tryeza të tjera, gjatë të cilave do të diskutohet për cilësinë në arsim, tekstet shkollorë, bibliotekat, laboratorët në shkolla, mësimdhënësit dhe shkollimin profesional. /Kosova-Press

CILAT JANË KËRKESAT E INVESTITORËVE GJERMANË NË SHQIPËRI?

Ajo çka kërkojnë investorët në Shqipëri është: siguri ligjore, transparencë dhe një administratë mirëfunktionale, efektive dhe jo të korruptuar

Me ftesë të Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA), u bashkuan në pritjen e përvitshme të DIHA-s në Tiranë përfaqësues të qeverisë shqiptare, parlamentit dhe ekonomisë si dhe të ftuar të tjerë.

Pas përshëndetjes nga Presidentja e DIHA-s, Stephanie Siegfjalën e mori ambasadorja gjermane Susanne Schütz dhe ministrja shqiptare e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, të cilat paraqitën bilancin e marrëdhënieve ekonomike gjermano-shqiptare, përcjell albinfo.ch.

Ambasadorja Schütz u shpreh në këtë kontekst: "Shqipëria ka një potencial ende të pasfrytëzuar në



shumë fusha, para së gjithash në fushën e turizmit, energjisë së rinovueshme, bujqësisë moderne dhe shërbimeve. Ne shohim tashmë një interes të shtuar të sipërmarrjeve gjermane për Shqipërinë. Investorët dëshirojnë të dëgjojnë histori suksesi nga sipërmarrje, të cilat janë tashmë prezente në tregun shqiptar", është shprehur Schutz.

"Ajo çka kërkojnë investorët në Shqipëri është: siguri ligjore, transparencë dhe një administratë mirëfunktionale, efektive dhe jo të korruptuar. Për fat të keq, shpe-

sh investorët gjermanë dhe të huaj, të cilët kanë tashmë përvojë në tregun shqiptar, kanë shprehur kohët e fundit dyshime serioze dhe shqetësime të shtuara, për sa i përket një mjedisi "fair" në sektorin e ekonomisë në Shqipëri.

Dëshiroj të inkurajoj të gjithë pjesëmarrësit, të rigjallërojnë entuziazmin e tyre, i cili u zgjua këtu në Tiranë në maj të vitit 2015 nga Kancelarja Federale, Angela Merkel gjatë hapjes së Konferencës Ekonomike Gjermano-Shqiptare", është shprehur ambasadorja gjermane në Tiranë.



Në Strasburg po mbahet takimi i përbashkët i KPSA-së, BE-Kosovë

Komisioni Parlamentar i Përbashkët për Stabilizim Asociim, BE-Kosovë, po mban sot në Strasburg mbledhjen e 6-të të përbashkët, në të cilën pjesëmarrës janë 13 anëtarë nga Parlamenti Evropian dhe 13 anëtarë nga Kuvendi i Kosovës. Përfaqësues nga Qeveria e Kosovës është ambasadori i Kosovës në Bruksel, ndërsa përfaqësues nga Komisioni Evropian, David Cullen, udhëheqës i njësive në Drejtorinë e Përgjithshme për ish-Republikën e Maqedonisë dhe Kosovës. Në takim po shkëmbehen pikëpamje lidhur me situatën aktuale të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe BE-së. Temat tjera që do të diskutohen janë dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjendja sociale dhe ekonomike në Kosovë, si dhe liberalizimi i vizave.

PALOKA HAKMERRET ME BOJË

PD: Reagoi për bullizimin!

Parlamenti miratoi unanimisht protokollin për aderimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, por vota konsensuale nuk ishte tregues qetësie. Situata nisi të acarohet kur kryedemokrati Lulzim Basha fokusoi fjalimin e tij te protesta e së shtunës. "Ky sistem duhet përmbytur, merrni në dorë fatin tuaj", tha Basha.

Edi Rama nuk ndihmoi në shtensionimin e situatës kur e cilësoi rivalin e tij si një fëmijë, ndërsa i kërkoi ndjesë kryeparlamentarit të Shkupit, Talat Xhaferri, që ishte i ftuar në seancë: "Ndjesë, por fëmijë nuk i mendon ato që thotë dhe as nuk di çfarë thotë".

Pas këtyre fjalëve, nënkryetari demokrat i Kuvendit, Edi Paloka iu drejtua kryeministrit ndërsa mbante në duar një shiringë me bojë që e hodhi në drejtim të Ramës.

Kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi i kërkoi që të dilte jashtë, por Paloka refuzoi të largohej dhe Byroja e dënoi atë me 10 ditë përjashtim nga

punimet e Kuvendit. Ndërsa Partia Demokratike shpjegoi veprimin e nënkryetarit të saj: "Edi Paloka e gjuajti me bojë Edi Ramën, pasi ky e talli në mënyrë të përsëritur për shkak të mënyrës së të folurit. Gjuatja me bojë është mospranimi i bullizimit të ushtruar nga kryeministri për të cilin është dëshmitar i gjithë opinioni publik".

Selia Blu i referohet seancës së kaluar ku Rama imitonte TH-në në të folur të Edi Palokës.

Ndërsa vetë Paloka tha se motivi nuk ishte personal: "Ishte fillimi i 16 shkurtit".

Për incidentin reagoi edhe Garda e Republikës: "Në sallën e seancave të Kuvendit të Shqipërisë, deputeti Edi Paloka ka sulmuar me një solucion kimik të parapërgatitur Kryeministrin e Shqipërisë, z. Edi Rama. Garda e Republikës me mbështetjen e strukturave të specializuara të Policisë së Shtetit ka nisur hetimet e menjëhershme për agresionin e kryer në sytë e



të gjithëve dhe gjithashtu procedimin penal kundër shtetasit Edi Paloka".

Në përfundim të seancës, PS njoftoi se do kërkojë shkarkimin e Palokës nga detyra e n/kryetarit të Kuvendit. Ndërsa Rama reagoi me një postim në Facebook ku edhe publikoi videon e incidentit.

"Dy gjëra janë të pafundme, universi dhe budallallëku i njeriut", shkruante Albert Ainshtajni, përpara sesa opozita në Shqipëri të merrte formën e një Budallallëku Universal, që vizion ka Vezën e Lulit, ide ka Çizmen e Doktorreshës dhe program ka Bojën e Palothës", shkroi Rama në rrjetin social.



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka njoftuar se në takimi

min që kanë pasur gjatë mëngjesit me liderët e institucioneve dhe eki-

Haradinaj akuzon Thaçin se po bëhet zëdhënës i SHBA-së

pin negociator janë dakorduar për platformën për dialogun me Serbinë, e cila, sipas tij, i obligohet kushtetutshmërisë dhe është një garanci se nuk prekën kufijtë.

"Mendoj që platforma është një dokument i qëndrueshëm, i parimeve, por edhe i qëllimeve që

ka Kosova në dialog, buron nga Kushtetuta, mbron Kushtetutën e vendit dhe personalisht i jap përkrahje", tha Haradinaj, përcjell albinfo.ch.

Kryeministri kosovar ka folur edhe për mesazhet që po merr nga presidenti Thaçi për prishje të ra-

porteve me SHBA-në.

Haradinaj ka thënë se Amerikës nuk i dihet zëdhënës, se flet vetë. "As presidenti, as unë, as askush nuk është zëdhënës i Amerikës, nuk ka nevojë me fol për ta, ata flasin vetë, dinë me fol, i shpjegojnë gjërat", ka thënë Haradinaj.

Kamionët me ndihma humanitare të SHBA-së arritën javën e kaluar në qytetin kufitar Kolumbu, por u ndaluan në urën Tienditas, e cila është bllokuar nga trupat venezueliane të kontrolluara nga Maduro

VENEZUELA PO PËRBALLET ME KRIZË TË THELLË HUMANITARE



Të dërguarit e Guaidos u takuan me zyrtarët brazilianë këtë javë dhe njoftuan për planet për të krijuar një qendër të dytë të depozitimit të ndihmave në shtetin e Roraima, në kufirin juglindor të Venezuelës.

Kamionët me ndihma humanitare të SHBA-së arritën javën e kaluar në qytetin kufitar Kolumbu, por u ndaluan në urën Tienditas, e cila është bllokuar nga trupat venezueliane të kontrolluara nga Maduro.

Presidenti i kontestuar Maduro ende gëzon përkrahje të gjerë në mesin e popullatës dhe besnikërinë e ushtrisë, përderisa Qeveria e tij e majtë mbështetet nga Rusia dhe Kina.

Por, ai është nën presion kombëtar dhe ndërkombëtar për të thirrur zgjedhje të parakohshme presidenciale, mes akuzave për korrupsion të përhapur dhe shkelje të të drejtave të njeriut nën udhëheqjen e tij.

Marrëdhëniet mes SHBA-së dhe Venezuelës ishin të tensionuara përpara se administrata e presidentit Donald Trump të bëhej një nga të parët që do të mbështeste liderin e opozitës, Juan Guaidon si udhëheqës të përkohshëm.

Venezuela ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me SHBA-në, ndërsa presidenti Trump tha se përdorimi i forcës ushtarake mbetet "një opsion".

SHBA e ka akuzuar Qeverinë e

Maduros për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe korrupsion.

Rusia, të martën, ka paralajmëruar Shtetet e Bashkuara kundër ndërhyrjes në punët e brendshme të Venezuelës.

Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov i bëri komentet gjatë një telefonate me Sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, njoftoi Ministria e Jashtme e Rosisë.

Departamenti amerikan i Shtetit nuk e ka konfirmuar zhvillimin e bisedës telefonike. Moska i ka dhënë miliarda dollarë ndihmë Qeverisë së presidentit të kontestuar, Nicholas Maduro. Megjithatë, Venezuela ka rënë në kaos ekonomik. /REL



Takimi i NATO-s, Rusia në qendër të diskutimeve

NATO është trazuar që kur Moskë ka thënë se do të dalë edhe ajo nga pakti i çarmatimit INF, si reagim ndaj daljes së SHBA. Si duhet t' i përgjigjet Aleanca Veriatlantike rrezikut të raketave ruse? "Gjendja është "serioze", tani duhet menduar për një "botë pa paktin e çarmatimit", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Aleanca transatlantike nuk do që të nxihet për të gjetur përgjigjen e përshtatshme. Kjo u bë e qartë që në fillim të takimit dyditor të Këshillit të Mbrojtjes së NATO-s në Bruksel, takimin e parë të NATO-s që kur SHBA, e mbështetur nga NATO bëri të qartë në fillim të shkurtit se vetë do të dalë nga Pakti i Çarmatimit INF të lidhur me Rusinë, për raketat me rreze të mesme veprimi, të afta për t'u përdorur si armë atomike. Momentalisht, sipas zyrtarëve, Aleanca nuk punon as për të përjashtuar, as për të vendosur hierarki e as për të përfshirë. Shumë më tepër duhet lënë kohë për të diskutuar, për të vendosur në tavolinë një "propozim të arsyeshëm dhe të zgjuar". Ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, tregohet i kënaqur, ndryshe nga herët e tjera kur buxheti ka qenë arsye për grindje të vërteta. "Të gjithë anëtarët e NATO-s kanë dhënë më shumë para' për mbrojtjen", tha Stoltenberg. 16 anëtarë do të arrijnë deri në vitin 2024 synimin e deklaruar për të dhënë për mbrojtjen 2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Gjermania, e cila planifikon 1,5%, nuk është pjesë e tyre.

Pranga gazetares investigative

Maria Ressa, një ndër gazetaret investigative me famë botërore shoqërohet në polici në vendin e saj të lindjes Filipine. Agjentët e zyrës kombëtare hetimore shkuan në zyrat e portalit të saj investigativ Rappler në Manila.

Ressa është kritike ndaj presidentit Rodrigo Duterte. Ajo akuzohet për shpifje të shumëfishta, bazuar në një ligj të miratuar në vitin 2012 kundër shpifjeve në por-



talet në mediat online.

Akuza për të cilën u arrestua

është një shkrim investigativ që daton 4 muaj para miratimit të kë-

tij ligji në vitin 2012. Shkrimi hidhte dritë mbi një aferë korruptive mes një biznesmeni dhe një gjykatësi. Hetimi u hap fillimisht në vitin 2016 por u mbyll në atë kohë për mungesë të mjaftueshme provash për t'u rihapur vitin e kaluar. Maria Ressa ka qenë prej vitesh bashkëpunëtoresh e CNN në Manila dhe është shpallur ndër gazetaret e vitit për 2018-ën nga revista prestigjioze "Time".

NDËRHYRJET RUSE NË ZGJEDHJET E SHBA

ISH-NDIHMËSI I TRUMP MASHTROI PROKURORËT DHE FBI

Shefi i fushatës zgjedhore të Donald Trump, Paul Manafort shkeli marrëveshjen e tij të pranimi të fajësisë me këshilltarin e posaçëm Robert Mueller duke gënjyer prokurorët, thotë një gjykatës i SHBA.

Gjyqtari i gjykatës së rrethit amerikan, Amy Berman Jackson, vendosi që Manafort "bëri deklarata të shumta të rreme" tek FBI,

zyra e Mueller dhe para një jurie të madhe.

Mueller kryeson një hetim për ndërhyrjen ruse në zgjedhjet e vitit 2016 në SHBA.

Manafort është deklaruar fajtor për disa akuzat, duke shmanjur një gjyq të veçantë. Ai u dënua për mashtrime financiare në gusht, lidhur me punën e tij si konsulent politik në Ukrainë. Ai më pas

pranoi një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në akuzat të tjera, në këmbim për bashkëpunimin me hetimin e Mueller.

Në vendimin e të mërkurës, gjyqtari Berman Jackson tha se kishte prova që tregonin se Manafort kishte gënjyer rreth tre temave të ndryshme, duke përfshirë kontaktet e tij me Konstantin Kilimnik, një konsulent politik rus. Proku-

rorët pohojnë se Kilimnik kishte lidhje me inteligjencën ruse.

Megjithatë, gjyqtari e zhveshi Manafort, 69 vjeç, nga akuzat për gënjeshtra në dy çështje të tjera. Vendimi do të thotë se Manafort, i cili është mbajtur në një qendër paraburgimi në Virxhinia që nga qershori, tani mund të përballet me dënime më të ashpra ose të ngrejë padi kundër tij.



Vitin e kaluar, Mueller tha se Manafort gënjoi "për një varg çështjesh" pas nënshkrimit të marrëveshjes së pranimi të fajësisë.

Gjatë karrierës mbi 45-vjeçare artistike, Mili realizoi edhe disa filma të shkurtër artistikë, nga të cilët duhet të veçohet ai kushtuar xhaz muzikantëve të mëdhenj të kohës, "Jammin' the Blues". Shkaku i vlerave artistike dhe risive regjisoriale, ky film u nominua për çmimin Oscar në edicionin e vitit 1944

35-VJETORI I VDEKJES SË FOTOGRAFIT SHQIPTAR GJON MILI



Për shqiptarin që shkroi një nga faqet ma të lavdishme të historisë së fotografisë amerikane dhe asaj botërore.

Revista amerikane "Popular Photography", që dikur konsiderohej si më e madhja e llojit të vet në Amerikë dhe jashtë saj, numrin e parë e publikoi më 1937. Gjatë historisë 80-vjeçare, veç informacioneve për artin dhe zhvillimin teknologjik të fotografisë, revista ishte edhe prijëtare në prezantimin e fotografëve më të mirë të kohës – si në Amerikë, ashtu edhe në botë.

Siç shihet, në listë është edhe emri i gjenit shqiptar të fotografisë, Gjon Mili, i cili në pjesën e dytë të shekullit XX ka shkruar një nga faqet ma të lavdishme të historisë së fotografisë amerikane dhe asaj botërore.

Vlerësimi – apo përzgjedhja e këtyre emrave – është rezultat i sondazhit në të cilin janë përfshirë kritikët, mesimdhënësit, redaktorët, drejtorët artistikë, konsulentët dhe fotografët e angazhuar brenda dhe jashtë vendit. Nga 465 autoritete të kontaktuar, 243 prej tyre i janë përgjigjur sondazhit.

DHJETË MË TË MËDHENJTË E FOTOGRAFISË BOTËRORE

Sondazhi për dhjetë më të mëdhenjtë e fotografisë botërore, zgjoi sa reagime pozitive aq edhe dyshuese nëpër gazetatat që botoheshin asokohe në Amerikë. Nga to vlen të veçohet reagimi i gazetarit Jacob Deschin, i cili në artikullin e botuar në të përditshmen "The New York Times", më 6 prill 1958, ngre disa pikëpyetje lidhur me sondazhin e realizuar nga revista.

"Lista duket sikur u krijua rastësisht, pa ndonjë seriozitet, duke u mbështetur vetëm në reputacionin e fotografit. Për më tepër, në përzgjedhje duket se kanë ndikuar kryesisht pjesëmarrësit amerikanë, duke i dhënë listës frymë nacionale – e jo botërore, siç pretendohet", ka thënë ndër të tjera Deschin.

Pavarësisht reagimeve që vë-

nin në pikëpyetje listën e "dhjetë më të mëdhenjve" të fotografisë botërore, për lexuesin shqiptar – por edhe për historinë e fotografisë shqiptare – publikimi i sondazhit nga revista e sipërpërmendur, na sqaron një moment të panjohur për jetën dhe karrierën e fotografit shqiptaro-amerikan, Gjon Mili.

Mili u lind më 28 nëntor 1904, në Korçë, nga prindërit Vasil Mili dhe Viktori Çekani. Me ndihmën e dajës së tij, Koço Çekani, si 18-vjeçar emigron në Amerikë. Daja e ndihmon financiarisht, derisa nuk i mbaron studimet në Institutin e Teknologjisë të Massachusetts-it. Në këtë universitet prestigjioz ishte ndër studentët më të dalluar, për çka rekomandohet të fillonte punën si inxhinier në kompaninë e famshme të prodhimeve të mjetëve ndriçuese, Westinghouse Lamp Company. Për dhjetë vjet sa punoi në këtë kompani, do të vlerësohet si një nga punëtorët më të zotët dhe më inventivë.

Në vitin 1937 Mili do të njihet me profesorin Harold E. Edgerton – njeriu i cili zbuloi flashin elektronik dhe atë stroboskopik. Mes tyre nis një miqësi dhe bashkëpunim i gjatë, që do të shtyjë Milin të kombinojë elektronikën me fotografinë. Në vitin 1938, fal kësaj miqësie – dhe pas sugjerimit të Edgertonit për ta krijuar një portfolio me fotografi stroboskopike – fotografi shqiptar fillon punën në revistën e famshme LIFE.

GJON MILI TAKON PABLO PICASSON

Fal punës kreative dhe novative, Mili shpejtë do të bëhet foto-

grafi më i dalluar jo vetëm në LIFE, por edhe në komunitetin artistik amerikan dhe evropian. Kështu, në vitin 1949, gjatë realizimit të një reportazhi për artistët më të mëdhenj pamorë të shekullit XX, Gjon Mili takon Pablo Picasson në shtëpinë e tij në rivierën franceze. Aty ai realizon një varg fotografish me teknikën e tij origjinale, ku më e famshme mbetet ajo që do të quhet: "Picasso duke vizatuar Kentaurin me dritë". Një vit më vonë, në janar të vitit 1950, koleksioni i fotografive me Picasson ekspozohet në Muzeun e famshëm të New Yorkut, MoMA, ku do të përcillet me kërshëri të jashtëzakonshme si nga kritika ashtu edhe nga publiku amerikan.

Në vitin 1966, Gjon Mili përjeton një tragjedi: shkaku i instalimit të vjetër të rrymës elektrike, studion e tij në Rrugën 23 të New Yorkut e kaplojnë flakët e pakontrolluara, të cilat ia shkatërrojnë dy të tretat e materialeve të vlefshme (fotografi, negativë, dokumente e letërkëmbime të rëndësishme). Gjatë përpjekjes për ta shuar zjarrin e madh në studion e tij, vdesin 12 zjarrfikës.

Gjatë karrierës mbi 45-vjeçare artistike, Mili realizoi edhe disa filma të shkurtër artistikë, nga të cilët duhet të veçohet ai kushtuar xhaz muzikantëve të mëdhenj të kohës, "Jammin' the Blues". Shkaku i vlerave artistike dhe risive regjisoriale, ky film u nominua për çmimin Oscar në edicionin e vitit 1944.

Për veprën fotografike të Gjon Milit janë botuar tre libra. Në vitin 1960 botohet libri "The Magic of Opera" – libër ky i panjohur deri tani për opinionin shqiptar, që i ku-

shtohet historikut të Operës Metropolitane. Tri të katërtat e këtij libri janë të ilustruara me 68 fotografi të Milit, nga të cilat duhet të veçohet ajo e divës së operës botërore, Maria Callas. Tekstin e librit e ka shkruar kritikja e teatrit dhe muzikës, Mary Ellis Peltz.

Në vitin 1970 botohet libri "Picasso's third dimension", i redaktuar nga vet Gjon Mili, ku përfshihen fotografitë e realizuara nga dy vizitat – më 1949 dhe më 1967 – që ia ka bërë piktorit më të madh të shekullit XX. Libri përfshinë serinë e fotografive të "vizatimit me dritë", disa portrete – në mesin e të cilëve është ajo emblematikja, e Picassos me lulen e kuqe në vesh – si dhe fotografitë e dhjetëra veprave artistike që piktori i kishte në atelienë e tij. Teksti shpjegues i Milit karakterizohet nga një stil i rrjedhshëm dhe lehtë i kuptueshëm.

Në vitin 1980 botohet vepra "Gjon Mili – Photographs & Recollections", që mund të konsiderohet si libër monografik i gjenit shqiptar, i botuar tërësisht nën mbikëqyrjen e tij. Në tekstin e shkruar nga vet Mili, shpjegohet rrugëtimi i tij krijues – qysh nga fotografia e tij e parë artistike e realizuar në vitin 1931 (portreti i çelistes Margaret Aue), si dhe porositë e parë e bërë nga revista LIFE në vitin 1938 (ku portretizohet kampioni i tenisit në SHBA, Bobby Riggs).

Qysh në fillim të tekstit të kësaj monografie, Mili përmend shokërimin e tij me Faik Konicën, për të cilin thotë se "ishte një shok i moshuar shqiptar; një shkrimtar i shkëlqyer; një humanist dhe një

intelektual i mprehtë".

"Konica ka marrë mundin për të zgjeruar interesimin tim për artet, sidomos për filmat, të cilët i pëlqente dhe i konsideronte si një formë artistike më rëndësi...", ka shkruar ai.

Më tej Mili shprehet se kjo monografi nuk do të realizohej pa ndihmën e miqve në LIFE të cilët ia ofruan tërë arkivin fotografikë me autorësinë e tij, pasi shumica e fotografive në pronësinë e tij ishin shkatërruar në zjarrin e vitit 1966.

Libri përmban një numër të madh të kryeveprave të tij, duke filluar nga portreti i Picassos, nuçdoja që zbrit shkallëve (vepër e frymëzuar nga një pikurë e artistit konceptual, Marcel Duchamp), balerinave të fotografuara me stroboskopi (të cilat e impresionuan Picasson në takimin e parë), portreti i çelstit Pablo Casals, dramaturgut Sean O'Casey, regjisorit Alfred Hitchcock, pianistit Artur Rubinstein, piktorit Henri Matisse, këngëtarit Frank Sinatra, shansonieres Edith Piaf dhe shumë emrave të tjerë të mëdhenj të artit dhe të kulturës botërore...

Libri përfundon me një portret që Gjon Milit ia kishte realizuar fotografi i madh francez, babai i asaj që njihet si "Fotografi e rrugës" dhe si autori i librit eseistik "Çasti vendimtar" – i cili udhëzon për një qasje ndryshe në fotografinë bashkëkohore – Henri Cartier-Bresson (të cilin Mili me shaka e thërriste "amator")

Pas një sëmundje nga pneumonia, Gjon Mili vdiq më 14 shkurt të vitit 1984, në Stamford-Connecticut të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. /Telegrafi/

“Romani ‘Kronikat e mjegullës’ jep mundimet shqiptare nën atmosferën e viteve ’30, me ironi dhe ndërgjegje se si e kaluara mbetet për individin shqiptar aq e afërt në psikozë, mentalitet, përballë pushtetit, parasë dhe seksit, nga njerëzit e rëndomtë deri në autoritetet drejtuese, ose asaj që ashtuquajmë—elitë”

Fatmira Nikolli

Ka mjaft mjegull në shkrimin e historisë sonë, ka mjaft trukime. Në shumicën e rasteve historia e shkruar është shkruar për t'u shërbyer interesave të ditës dhe kjo ka sjellë mjaft gjëra të paqarta, mjaft mjegull në këto kronika. Bashkim Hoxha e shpjegon edhe kështu raportin tonë me historinë, teksa do vijë para lexuesit me një roman që zhytet thellë në kohë.

Janë vitet 1930, Shqipëria drejtohet nga Zogu, shteti po rreket të marrë tiparet moderne duke lënë pas 500 vitet nën Perandorinë Otomane.

Romani nis pothuajse brutalisht, sjell një ndjesi të “frikshme” për shkak të një gjendjeje perverse dhe banale që pothuaj duket se e penalizon vetë romanin. Por sapa mendon se është i rëndë, një faqe më tej, shpërfaqen reale e të fortë, të ashpër e krenarë, të pagdhundur e të papjekur, të zotë e zgjuar, zengjinë e fshatarë, profilet e burrave shqiptarë. Diku-diku janë krejt, të zakonshëm, mandej tërësisht atipikë, diku janë heronj e matanë imoralë, të pagdhundur. Ai duket se ridimensionon një histori, duke dashur të vërë përballë jetët njerëzore dhe madje anët e të njëjtë njeri, ku qëndrojnë përkrah ana njerëzore, banale, brutale ndaj historisë së trukuar e monumentale.

E ka titulluar “Kronikat e mjegullës” dhe ndjen në të një atmosferë shqiptare tipike për kohën. Në një farë mënyre, Hoxha sjell

AZIS BEU DHE HËNA, NJË HISTORI NGA VITET 1930



këndvështrimin e tij personal që i është rrënjësuar mbi historinë e kohës. Thotë se një vështrim të tillë i ka sjellë edhe letërsia në përgjithësi. “Por, përveç këtij këndvështrimi, letërsia ofron edhe një mënyrë tjetër për ta kundruar historinë si një jetë njerëzore, madje edhe në mënyrë anekdotike. Pikërisht kjo mënyrë e të vështruarit ndryshe të historisë nga letërsia më ka ngacmuar prej kohësh për të shkruar këtë roman. Kam katër vjet që merrem me të”, – ka thënë Hoxha.

Shkrimtari, gazetari dhe dramaturgu që drejton Teatrin “Aleksandër Moisiu” mendon se tri sfidat kryesore gjatë shkrimit të romanit kanë qenë pikërisht, përplasja me këndvështrimin e historisë me të cilën na kanë indoktrinu deri tani, krijimi i raportit

të historisë me jetën e thjeshtë dhe banale njerëzore dhe sfida e tretë ka qenë që e gjithë kjo të vijë përmes letërsisë dhe këtu e ka ndihmuar shumë “Dekameroni” dhe Konica.

“Romani ‘Kronikat e mjegullës’ jep mundimet shqiptare nën atmosferën e viteve ’30, me ironi dhe ndërgjegje se si e kaluara mbetet për individin shqiptar aq e afërt në psikozë, mentalitet, përballë pushtetit, parasë dhe seksit, nga njerëzit e rëndomtë deri në autoritetet drejtuese, ose asaj që ashtuquajmë – elitë”, shkruan gazetaria Violeta Murati në një bisedë të bërë me të.

Romani është i ndarë në “kapituj” që mbajnë emërtesa burrash e profile burrash. Mbi dhjetë portrete meshkujsh, për secilin nga një karakter e nga një qëllim. Kur pyetet se pse e ndan kaq shumë këtë histori me shqiptarët burra ai ka thënë se ka qenë e qëllimshme, por kjo ka ardhur si pjesë e natyrshme e historisë sonë. “Në rreshtin e parë kanë qenë gjithmonë burrat, vendimet merreshin në logun e burrave, vendimet e tyre i kanë dhënë tonin jetës njerëzore në përgjithësi. Me sa duket, në këtë aspekt kam respektuar një realitet historik. Azis beu na vjen si protagonist, duke ndjekur sagën e transformimit të tij – pothuaj e një politikani sot, që nuk shfaq kurrë pendim, ndërgjegje, duke ndërtuar një botë njerëzore me të cilët nuk duhet të merremi seriozisht”. Por ai mohon të ketë qenë alibi e shkrimtarit për të justifikuar romanin apo moralin personal. “Azis beu dhe Hëna janë dy personazhet kryesorë rreth të cilëve vërtitet historia e mbushur me dashuri dhe armiqësi. Janë personazhe që unë i dua, për faktin se nuk mund të thuash se cili është i mirë apo cili është i keq. Janë rrethanat që

i bëjnë ata të duken të këqij apo të mirë”.

Duke qenë se atmosfera e romanit na çon në vitet ’30, e gjen edhe personazhe realë si Konica, në të ndjehet atmosfera ironike si te Doktor Gjilpëra, tani jo murtaja fizike, por ajo mentale e drejtpërdrejtë ku, për të kërkuar se kush janë shqiptarët ai bën një “bisedë” me Konicën dhe Fishtën, Krist Malokin e Mbretin Zog. “Konica ka qenë frymëzimi im. Vështrimet e tij kontroverse dhe realiste gjithmonë më kanë ngacmuar, por në këtë roman më ka pëlqyer edhe fakti se ai dhe personazhet e tjerë historikë janë vetëm figurantë të historisë që përjetojnë personazhet e tjerë letrarë dhe jo historikë. Unë e besoj se ‘çdo njeri është i rëndësishëm në jetën e tij’- thotë Hoxha.

Meqë kam patur fatin ta lexoj dorëshkrim, dëshiroj të them që kemi të bëjmë me një roman krejt të veçantë në letrat shqipe, por edhe në galerinë e pasur të Bashkim Hoxhës. Kësaj here jemi në një roman brez-nish, ku historia politike e shekullit XX rrëfëhet me mjaft mjeshtëri, guxim, madje pa droje për të shembur idhujt. Ky libër nuk duhet të mungojë në bibliotekë, ndërkohë që nuk lexohet, por përpiket me një frymë”, ka shkruar Kel Demi. Ndërsa sipas Rezarta Reçit, romani ka një “ide të guximshme, e realizuar zhdërvjellshëm e me kujdes në një rrem të bukur e të pazakontë ku historia e popullit tonë ngrihet e bie bashkë me heronjtë e vet, siç ka ndodhur realisht nga njëra kronikë tek tjetra, nga njëra stinë politike tek tjetra për fatin tonë të keq historik, por aq fatmirë për shkrimtarin Bashkim Hoxha që ka mundësi të luajë me alën, idenë, gjuhën e zgjedhur, mjetet rrëfimtare ku dominon ironia”.

TESTAMENTI I HYGOIT, QË I LA TË VARFËRVE 50.000 FRANGA Shkrimtari i madh, shkruajti që beson në Zot, por refuzoi ceremoninë nga kisha

Siç pati veprën, ashtu la edhe testamentin. Të madh.. Duke lënë, gjithashtu krejt Francën e atëherëshme gojëhapur për bujarinë e tij.


Viktor Hygo, shkrimtari i madh francez, u fali të varfërve në testamentin e tij, plot 50.000 franga. Të barazvlefshme sot me rreth 1 milion \$. Ai ia besoi ato një institucioni bamirësie, me kusht që të ndihmojnë njerëzit e varfër, jetimët dhe ata pa shtëpi. Gjithmonë i ndjeshëm ndaj shtresave të skamura në veprën e tij, autori i “Të mjerët” dhe “Katedralja e Parisit”, tregoi në fund të jetës, që ai ishte tamam ashtu siç kaloi dhe jetën, bujar dhe fisnik. Ai u varros në vitin 1885, në Paris, në një ceremoni të thjeshtë, pa fjalime, por ndjekur nga një masë e madhe lexuesish dhe dashamirësish. “Unë, Viktor Hygo, i lë të varfërve 50 mijë franga. Po ashtu, refuzoj fjalimet nga kishat dhe lutem për të gjithë shpirtrat e njerëzve të mirë. Unë besoj në Zot”.

Sipas një studimi të vitit 2014 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shumica e njerëzve lexojnë mesatarisht rreth 19 minuta çdo ditë. Rezultati ndryshon kur flasim për grupmosha, pasi, po sipas këtij studimi, të rinjtë e moshës 25-34 vjeç lexojnë më pak, disa minuta në ditë.

Rezultatet nuk janë optimiste. Me ritmin e shpejtë të jetës, mbase harxhimi i orëve të tëra me një libër duket si mision i pamundur, por ju premtoj se me gjithë aktivitetet e tjera jetësore, gjithmonë mbeten më shumë se 20 minuta për t’u përkushtuar leximit. Tani, përveç preferencave dhe studimeve, a ka një të dhënë shkencore mbi kohën që duhet të kalojmë duke lexuar?

Të gjithë e dimë që leximi ndihmon në përmirësimin e kujtesës dhe uljen e stresit. Me shumë mundësi këto përfitime nuk na vijnë për pak minuta, shkruan botimeshqip.com

Sa duhet të lexojmë?



Në fakt, ka disa udhëzime shkencore mbi kohën dhe cilësinë e leximit. Shifrat mund t’ju habitin.

1. Mund të lexoni vetëm 30 minuta çdo ditë

Studimet kanë treguar se ata që lexojnë të paktën 30 minuta çdo ditë jetojnë të paktën 2 vite më shumë se të tjerët që nuk lexojnë.

2. Por... 30 minuta çdo ditë për vite me radhë

Nuk është e mjaftueshme të lexosh 30 minuta në ditë për pak kohë. Studimi i mësipërm u realizua gjatë 24 viteve. Bëni mirë të nisni!

3. E rëndësishme është çfarë lexon

Përfitimet më të mëdha i kanë njerëzit që lexojnë letërsi artistike. Në fakt, sipas studimeve, subjektet që lexojnë letërsi 30 minuta në ditë për vite me radhë jetojnë më gjatë se ata që lexojnë vetëm gazeta e revista.

4. Shpejtësia e leximit është e rëndësishme

Nuk mund të uleni për 30 minuta, të lexoni vetëm një faqe me 3000 karaktere dhe ta quani punën të kryer. Shpejtësia e leximit ka rëndësi, gjithmonë pa humbur përqendrimin dhe kuptimin e asaj që po lexoni.



Argjentinasiit kane dy pasione absolute: futbollin dhe dhunen. Edhe me shumë se në Brazilin fqinjë. Argjentinasiit hanë futboll, pinë futboll, jetojnë në futboll

PASIONET ABSOLUTE TË ARGJENTINËS



Shumë shpesh edhe lojtarët shndërrohen huligane në fushë. Pra edhe lojtarët shpesh nuk lënë të paeksploruar, kur është fjala për dhunën. Në Kupën e Botës 1966, Anglia mundi 1-0 Argjentinën. Pasoja: ata u mblodhën rreth gjyqtarit dhe u përpoqën të sulmonin dhomën e veshjes angleze. Një forcë policore duhet të përdorej për të mbrojtur lojtarët

ARGJENTINASIT HANË FUTBOLL, PINË FUTBOLL DHE JETOJNË NË FUTBOLL!

Në këtë drejtim, Buenos Aires është një fuçi baruti e lojës me këmbë. Qyteti ka jo më pak se dhjetë klube profesionale - dhe secili prej tyre ka një grup përkrahës super fanatik dhe gjithashtu super të dhunshëm. Dy gazetarë të BBC-së shkruan një libër për të. Një pjese nga ai artikull është cituar me poshtë:

Gjaku i rrafshët rrjedh rregullisht nëpër rrugët e Buenos Aires. Dhe jo vetëm gjakderdhje. Që nga grushti ushtarak i vitit 1943, vendi ka qenë në të vërtetë skena e dhunës politike. Kupa Botërore e vitit 1978 u shpërnda në diktaturë me duar të kuq të errët. Janë të pakta vende ku të drejtat e njeriut janë shkelur sistematikisht si në Argjentinë. Tortura, ekzekutime, zhdukje, arrestime: të gjitha ndodhën. Lista është shume e gjatë. Ata që guxuan të hapnin gojën e tyre u zhdukën nga vendi i ngjarjes.

Dhuna dhe agresioni janë ne gjakun e çdo argjentinasi. Përzieri këtë predispozicion natyror ndaj

dhunës me fanatizmin e futbollit dhe keni një koktej vdekjeprurës. Zyrtarisht ka 250 vetë të vrarë në Argjentinë për shkak të dhunës në futboll. Por ky është numri zyrtar. Sa është me të vërtetë, askush nuk e di me saktësi. Dhuna e parë ne futbollin Argjentinasi daton në vitin 1916, jo më pak se viti kur ushtarët anglezë dhe gjermanë morën një armëpushim gjatë Luftës së Parë Botërore për të luajtur së bashku një lojë futbollit. Një ndeshje mes Argjentinës dhe Uruguajit duhej të ndalej sepse kishte shumë luftime në tribuna. I pari i vdekur ra në 1939, gjatë një ndeshje mes Boca dhe Lanus. Një incident në fushën e lojës ku u përfshinë tifozë të të dy ekipeve, çoi në një kontrahurë të vërtetë, në të cilin një oficer policie, nxori pistoletën e tij të shërbimit dhe gjuajti disa të shtëna. Dy tifozë u goditën dhe vdiqën në vend.

Vetëm në fund të viteve 1950 filloi organizimi i grupeve mbështetës huliganë. Emri i grupimit është Barras Bravas, që do të thotë

po aq 'bandat e guximshme'. Dhe ata kanë ndikim në largësi, përtej stadimeve. Shumë shpesh edhe lojtarët shndërrohen huligane në fushë. Pra edhe lojtarët shpesh nuk lënë të paeksploruar, kur është fjala për dhunën. Në Kupën e Botës 1966, Anglia mundi 1-0 Argjentinën. Pasoja: ata u mblodhën rreth gjyqtarit dhe u përpoqën të sulmonin dhomën e veshjes angleze. Një forcë policore duhet të përdorej për të mbrojtur lojtarët.

Një vit më vonë, kur Celtic luajti për Kupën e Botës kundër Racing Club, jo më pak se gjashtë lojtare u larguan nga fusha me kartonë të kuq. I fundit që morri të kuqe ishte Schot Bertie Auld, por ai thjeshtë refuzoi të largohej nga fusha ... dhe u lejua të vazhdonte të luante! Në 1971 Boca Juniors luajti kundër Sporting Cristal nga Peru. Në atë ndeshje, jo më pak se nëntëmbëdhjetë lojtare u larguan nga fusha e lojës, po ashtu kishte edhe arrestime. Në Argjentinë gjithçka është e përqendruar në


Buenos Aires, kështu që ne vendosëm të qëndrojmë në qytet. Së bashku me një tifoz të Independiente, do të shkonim në ndeshjen e Independiente-Racing Club. Kështu që ne mund të hynim brenda në të. Ne u bëmë si mysafirë të Djajve të Kuq, thelbi i klubit në shtëpi, i cili do të siguronte gjithashtu sigurinë tonë. Në mesditë, katër orë para sinjalit të parë, kemi pasur një takim me Pablo Alvarez, me nofken Bebote, ose 'Big Baby'. Ne duhej të ishim atje pikërisht në mesditë, sepse "Big Baby" kishte më shumë për të bërë përgatitjet e ndeshjes. Saktësisht ne raportuam ne kohe reale në Estadio Libertadores de America, shtëpi e Independiente. Endërtuar në vitin 1928 dhe lloji që nuk shihni më ne stadiumet evropiane: stalla të mëdha prej betoni dhe gardhe me tela me gjemba. Midis fushës dhe tribunës ishte një kanal ku ndodheshin mbetje të pista. A ka përfunduar ndonjëherë kanalizimi këtu? Asnjë ide, por ishte e sigurt se asnjë mbështetës nuk do të guxonte të hynte

në të.

Në vitin 1997, gjatë Independiente kundër Racing, një thikë u hodh tek portieri nga tribuna e Djajve të Kuq. Kjo çoi në krisje marrëdhëniesh. Tre muaj më vonë, kur Racing dhe River Plate u përballën me njëri-tjetrin, Waldo Rodriguez, një anëtar i spikatur i Racing Stone, divizioni huligan i Racing Club, humbi jetën. U tha gjerësisht se kjo ishte puna e tifozëve të Independiente. Në prill të vitit 1999, Hoolies nga Racing dhe Gimnesia mbajtën një marshim të qetë protestues për të shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj një numri vendimesh arbitrare. Marshimi u sulmua nga Djaj të Kuq dhe shtatë vetë u plagosën rëndë. Dhe njëri u qëllua për vdekje.

Në vitet e mëvonshme plagosje plumbash do të ndodhin më shpesh në derbin e Independiente-Racing. Dhe pas ndeshjes Racing-Belgrano, një tifoz i Racing morri më pak se shtatëmbëdhjetë goditje. Ai vdiq në vend - dhe hooliganet e Independiente ishin atje. Dhe se fundmi ishte kryendeshja finale e Kupës Libertadores 2018 midis rivaleve historike Boca Junior - River Plate. Ndeshja duhet të luhej në Evropë për shkak të trazirave. Edhe aty ishte dhuna e ushtruar ndaj autobusit të Bocas. Dhe gjithçka tjetër mbetet histori... por nuk ka për tu ndalur asnjëherë aty. (Rewu.nl)





Vdekja e basketbollistit në aksidentin tragjik, anulohen ndeshjet e kupës

Shkup, 14 shkurt - Federata e Basketbollit të Maqedonisë ka anuluar të gjitha ndeshjet e Kupës, për shkak të tragjedisë në aksin rrugor Shkup – Tetovë, ku mbetën të vdekur 14 persona, ndër ta edhe një basketbollist i ri i Klubit të Basketbollit Gostivari Jovica Tërpevski. "Një aksident tragjik mbrëmë e mbuloi vendin tonë me të zejë. 14 persona e humbën jetën, mes të cilëve edhe një basketbollist i ri i Klubit Gostivari. Për shkak të kësaj situatë, Federata e Basketbollit të Maqedonisë mori vendimin për të shtyrë ndeshjet e Kupës të cilat ishin paraparë të zhvillohen këtë fundjavë. Asnjë fjalë nuk do të jetë e mjaftueshme për të afërmit e viktimave. Ngushëllime të sinqerta familjarëve dhe miqve të viktimave" thuhet në komunikatën e Federatës së Basketbollit të Maqedonisë. Jozyrtarisht mësohet se ndeshjet e Kupës së Maqedonisë do të luhen në fund të muajit mars ose në fillim të prillit. Ndërkohë, është bërë e ditur se Tërpevski është djali i një deputeti të Kuvendit nga radhët e LSDM-së.

OSMANI: JEMI GATI PËR SEZONIN PRANVEROR


"Mendoj se jemi gati, formacionin deri diku e dimë, ndoshta një apo dy pozita jemi në dyshim, por kemi kohë të mjaftueshëm këto ditë të zgjidhim këto dilema", analizon fazën përgatitore trajneri Qatip Osmani

Shkup, 14 shkurt - Kuqezinjtë duken të gatshëm për vazhdimin e garave në LPFM ku objektivi është fitimi dhe mbrojtja e titullit të kampionit. Stafi teknik është në fazën e fundit të zgjedhjes së formacionit dhe strategjisë që pritet të sjellë suksesin. Shkëndija zhvillon fazën e fundit të përgatitjeve dimërore para vazhdimin të garave në LPFM. Kuqezinjtë kanë lënë pas dy fazat paraprake në të cilat u punua në Tetovë dhe Antalia të Turqisë, ndërsa përveç seancave stërvitore dhe punës në planin teknik taktik e fizik, u zhvilluan edhe gjashtë ndeshje kontrolluese (2 në Tetovë dhe 4 në Turqi) në të cilat ekipi manifestoi ngritje të formës në nivelin e dëshiruar (Në Tetovë u mundën me rezultat identik 2:1 Renova dhe Makedonija Gj.P., ndërsa në Antalia fituam Grashopperin e Zvicrës 2:0



(ndeshje e ndërprerë në minutën e 37-të shkaku i motit të keq) dhe FC Orenburg nga Rusia 2:0, ndërsa barazuar 2:2 me St. Poltenin e Austrisë dhe Zeljezničarin e Bosnje e Hercegovinës. "Jam i kënaqur me nivelin që kemi arritur në këto përgatitje. Në Antalia zhvilluam katër ndeshje kontrolluese me rival cilësorë, ndërsa gëzon fakti që në ndeshjen e fundit treguam karakter të rikthehemi në lojë edhe pse u gjetëm në negativë. Mendoj se jemi gati, formacionin deri diku e dimë, ndoshta një apo dy pozita jemi në dyshim, por kemi kohë të mjaftueshëm këto ditë të zgjidhim këto dilema", analizon fazën përgatitore trajneri Qatip Osmani. Katër ditë para fillimit të garave në gjysmëstatorin pranveror "kuqezinjtë" kanë bërë të ditur edhe

numrat që do të mbajnë lojtarët në periudhën në vazhdim. Numri i ri '10' i Shkëndijës tashmë dihet se është përforsimi i janarit, Agim Ibraimi, ndërsa ka ndërruar numrin edhe sulmuesi Samir Fazli që për dallim nga vjeshta kur luante me nr. 99, në vazhdim do të paraqitet me fanellën me numër 9. Shkëndija në pranverë do të ketë konkurrencë të bollshme në çdo pozitë, ndërsa shkaku i numrit të madh të futbollistëve disa lojtarë janë lëshuar në huazim në skuadra tjera. Remzifaik Selmani është huazuar për gjashtë muaj te KF Llapë i Kosovës, portieri Saladin Mustafi ka kaluar te FC Shkupi në huazim, Arlind Aliti gjashtë muajt e ardhshëm do të jetë pjesë e KF Struga Trim Lum si dhe Bashkim Lama dhe Iljaz Çilafi ka përforsuar KF Gostivarin.



Sejdini pritet të kandidojë për kryetarë të FFM-së

Shkup, 14 shkurt - Me 17 mars të këtij viti Federata e Futbollit të Maqedonisë do të mësojë emrin e udhëheqësit të ri. Deri më tani nuk ka ende asnjë kandidat që do të pretendojë pozitën e të parit të futbollit në vendin tonë, ndërsa 25 shkurti është data e fundit që kandidatët mund t'i dorëzojnë kandidaturat e tyre. "Çdo Lidhje Komunale e futbollit mund të propozon kandidatin e mundshëm për kryetar të Federatës. Zhvillimet shkojnë në mënyrë sa më të mirë. Kuvendet janë duke ecur mirë deri më tani dhe janë mbajtur diku 10 apo 12 kuvende. Kështu që deri më tani nuk ka ndonjë kandidat, ndërsa mundësia për t'u paraqitur ndonjë kandidat është deri më 25 shkurt. Kështu që ditëve në vijim ndoshta do të kemi kandidatin zyrtar për kryetar të FFM-së", ka thënë ushtruesi i detyrës së presidentit të FFM-së, Muhammed Sejdi. Sejdi ka folur edhe rreth kandidaturës së tij për president të kësaj federate. "A do të jem un kandidat i mundshëm për kryetar të Federatës apo jo, kjo gjë do të zbardhet më 21 shkurt, kur do të mbahet edhe Kuvendi i Lidhjes Futbollistike komunale në Kërçovë, pasi unë vij nga Kërçova dhe e njëjta ka të drejtë të bëjë propozimin tim. Më 21 shkurt pra do të dihet edhe zyrtarisht a do të jem kandidat apo jo", ka thënë ai. Me 17 mars, në kuvendin zgjedhor të FFM-së, përveç zgjedhjes së presidentit të FFM-së, do të mësohet edhe llogaria përfundimtare për vitin 2018, si dhe buxheti për vitin 2019.

Avdijaj drejt Luzernit

tuar gazeta e madhe zvicerane "Blick". Mësohet se Luzerni tashmë është futur në negociatë me ekipin holandez Willem II, që e ka nxjerrë Avdijajn në shitje për mungesë të disiplinës. Pritet që brenda këtyre ditëve Avdijaj të zyrtarizohet te Luzerni, pasi afati kalimtar i janarit në Zvicër mbyllet të premten në orën 23:59. Avdijaj 22-vjeçar, te Willem II është transferuar para fillimit të këtij edicioni dhe ka firmosur kontratë deri

në qershor të këtij viti, me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër. Ai ka shënuar tetë gola dhe ka bërë gjashtë asistime në 19 paraqitje për Willemin, por është përjashtuar nga ekipi i parë për shkak të thyerjes së rregullave të disiplinës. Avdijaj ka gjashtë paraqitje me Kosovën, kurse karrierë ka bërë edhe te Roda, Sturm i Schalke. Skuadra e Luzernit renditet e gjashta në Superligën zvicerane.



Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Donis Avdijaj, pritet që karrierën ta vazhdojë në Zvicër, te skuadra e Luzernit. Kështu ka njoftuar

Ndong gati për sezonin e ri

Shkup, 14 shkurt - Skuadra e Shkupit tani më është duke zhvilluar përgatitjet përfundimtare, vetëm pak ditë para fillimit të sezonit pranveror, ndërsa ekipi nga dita në ditë po merr formën e saj. Lajm i mirë për të gjithë në klub, është se tani më stërvitjet me ekipin i ka filluar Basilio Ndong, i cili që nga nëntori i vitit të kaluar, ishte jashtë terreneve sportive. E gjithë kjo kishte ardhur si shkak i lëndimit të gjatë që e kishte munduar futbollistin nga Gui-

neja Ekuatoriale. Edhe përkundër përpjekjeve të shumta, që gjithçka të kalojë me terapi të shpeshta, në fund ishte e patjetërsueshme intervenimi kirurgjikal, që futbollisti 20 vjeçar ishte së bashku me ekipin në Antali dhe kishte punuar në fillim i diferencuar nga ekipi, që më pas ngadalë të bashkohet me skuadrën, por vetëm duke kryer vrapime të lehta. Nga kthimi në

Shkup, Basilio ka marrë dritë jeshile nga stafi mjekësor dhe tani më do të jetë i gatshëm që të ndihmojë ekipin e udhëhequr nga trajneri Umit Karan, i cili do të ketë zgjedhje më të madhe të lojtarëve. Ndong me Shkupin është bashkuar nga janari i vitit 2018, ndërsa këtë sezon kishte tetë paraqitje në kampionat dhe në dy ndeshjet e luajtura në kuadër të kualifikimeve të Ligës së Evropës, ndaj skuadrës së Glasgoë Rangers.



Furnizim, dorëzim, instalim dhe lëshim në punë nga ana e furnizuesit të pajisjeve dhe softuerit për zbulim dhe matje të rrjedhjes, GIS-softuerit për furnizim me ujë dhe kanalizim, duke përfshirë edhe video mbikëqyrje për video inspektim të kanalizimit.



Numri i referencës: BMP1/2.2/2181/2017-1/2019

Ndërmarrja publike komunale "Ujësllësi dhe kanalizimi" - Prilep ka për qëllim të jep marrëveshje për furnizim të "Sistemit për zbulim të rrjedhjeve dhe pajisje për matje, GIS - softuer për furnizim të ujit dhe kanalizimit, duke përfshirë edhe video mbikëqyrje për kanalizim" në Prilep, Republika e Maqedonisë me ndihmë financiare nga Interreg Balkan Mediteran Programi 2014-2020 (IPA II).

Dosja tenderuese është në dispozicion në ueb faqen e Ndërmarrjes publike komunale "Ujësllësi dhe kanalizimi" - Prilep www.vikpp.com dhe do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Prilepit: <https://www.prilep.gov.mk/>

Afati përfundimtar për parashtrimin e ofertave është ora 12:00 sipas kohës lokale më 18 mars 2019. Informacione shtesë të mundshme, ndryshime ose shpjegime/pyetje do të publikohen në ueb faqen e Ndërmarrjes publike komunale "Ujësllësi dhe kanalizimi" - Prilep:

www.vikpp.com ose në e-mail: vodovodpp@yahoo.com

Supply, delivery, installation and putting into operation by the Contractor of leak detection system and measuring equipment, GIS software for Water supply and drainage including CCTV for sewer video inspection



Publication reference No. BMP1/2.2/2181/2017-1/2019

Public Communal Enterprise Water Supply and Sewerage Prilep intends to award a supply contract for **Purchase of leak detection system and measuring equipment GIS software for Water supply and drainage including CCTV for sewer video inspection** in Prilep FYROM with financial assistance from the Interreg Balkan Mediterranean 2014-2020 [IPA II].

The tender dossier is available on the website of the Public Communal Enterprise Water Supply and Sewerage Prilep: www.vikpp.com and will also be published on the website of Municipality of Prilep: <https://www.prilep.gov.mk/>

The deadline for submission of the tender i.e. offer is 12:00 hours local time, 18 of March 2019. Possible additional information, changes or clarifications/questions shall be published on the website of the Public Communal Enterprise "Water Supply and Sewerage" Prilep :

www.vikpp.com or via e-mail: vodovodpp@yahoo.com

Në bazë të nenit 169, nenit 172 të Ligjit për arsim sipëror (Gz. Zyrtare e RM nr.82/2018) dhe vendimit të Këshillit mësimitor-shkencor, dekani i Fakultetit për edukatë fizike, sport dhe shëndet në Shkup, publikon

KONKURS
për zgjedhje të mësimeve në të gjithë titujt mësimitor

- zgjedhje të 1 (një) mësimeve në të gjitha titujt mësimitor në sferën mësimore-shkencore: kinezologjia e zbatuar, për realizim e lëndës: sport dhe shëndet. (zgjedhja është për periudhën prej pesë vite)

Kushtet: Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta të parapara me Ligjin për arsim sipëror dhe aktet tjera të Universitetit.

Vendi i punës- mësimeve në titull mësimitor, orari i punës është 40 orë në javë, me dy ndërrime: dy javë paradi nga ora 7.30 deri 15.30, dy javë pasdite nga ora 13.30 deri 21.30, sipas orarit të orëve në semestër. Bruto pagesa fillestare është 43.372,00 denarë.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrorjnë: fletëparaqitje sipas konkursit, biografi të shkurtër, dëshmi për përbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës (dokumente për arsim të mbaruar, listë të punimeve profesionale të botuara - nga një kopje nga punimet), certifikatë të shtetësisë.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas dispozitave të Ligjit për arsim sipëror (Gz. Zyrtare e RM nr.82/2018).

Dokumentet parashtrorhen në original ose kopje të vërtetuar në noter.

Konkursi zgjat 8 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e duhur të parashtrorhen në Fakultetin e edukatës fizike, sport dhe shëndet në Shkup, rr. Dimçe Mirçeçev nr.3, 1000 Shkup, F.postar 681.

Informata më të hollësishme në telefonin: 02 3113 654 Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup, Fakulteti për edukatë fizike, sport dhe shëndet - Shkup.

Fakulteti për edukatë fizike, sport dhe shëndet - Shkup

**REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E LIKOVËS**

Sektori për Punë komunale, urbanizëm, ndërtimtar, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ZHEL

Në bazë të nenit 35, paragrafi 3 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gz. zyrtare e RM-së" nr.199/14, 44/15), nenit 50, pika 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gz. zyrtare e RM-së" nr.5199/2014, 44/2015, 157/2015, 193/2015, 31/2016, 90/2017, 64/2018, 168/2018), nenit 22 të Statutit të Komunës së Likovës dhe miratimit të Programit vjetor për punimin e planeve urbanistike të Komunës së Likovës për vitin 2019 me Vendim nr. 08-1305/13 dt 26.12.2018 nga Këshilli i Komunës së Likovës, Kryetari i Komunës së Likovës e jep këtë:

LAJMI

Për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike për Propozimin e Kryetarit të Komunës së Likovës

Kufijtë e përfshirjes janë: **Planin Urbanistik Jashtë Vendbanimit të një pjese të PK. 31/1 KK Sllupčan - Komuna e Likovës**

Përfshirja është sipërfaqe prej 5,84 ha.

Anketa publike dhe prezantimi publik me propozim programin e Kryetarit të Komunës, do të zbatohet me ekspozimin e Propozim Planit në hapësirat e sallës të Këshillit të Komunës së Likovës.

Anketa Publike do të zgjatë 5 ditë pune edhe ate prej 25.02-01.03.2019, çdo ditë pune nga ora 10,00 deri 13,00.

Në afatin e përmendur, qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga rajoni konkret të përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Prezantimi publik me prezantimin profesional të planit do të mbahet më 27.02.2019 në ora 12,00 në hapësirat e sallës të Këshillit të Komunës së Likovës.

Punoi: Ida Diçe Arifi

Kontrollor: Feim Selmani

Aprovoi: Nexhadi Osmani

Komuna e Likovës
Kryetar
m-r Erkan Arifi



**REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E STRUGËS**

SHESHI "NËNË TEREZA" P.N., 6330 STRUGË
Tel. +389 46 781 335, 781 223, 782 015, Faks 781 434
ueb: struga.gov.mk, e-mail: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

Sektori: Sektori për planifikim hapësinor dhe veprimtari komunale
Njësia: Njësia për planifikim hapësinor, ndërtim dhe mbrojtje të ambientit jetësor

**Nr. 10-1992
27.12.2018
STRUGË**

SHPLLJE PUBLIKE

Në bazë të Nenit 84 dhe 86 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative ("G.zyrtare e RM-së" nr.38/2005, 110/2008, 51/2011 dhe 124/2015),

Kryetari i Komunës së Strugës duke vepruar sipas kërkesës së personave Izet dhe Qemajl Shazimanoski nga Struga, evidentuar me nr.10-1992 të datës 24.11.2018, ka dhënë leje për rrethim në KK Strugë, në bazë të PDU NJU-4 Strugë, Perëndim blloku 12, i sjellur me Vendim nr.07-1809/14 të datës 29.11.2007, në Pk.nr.1628 dhe Pk.nr.1629 P.N. nr. 03.57 KK Strugë.

Rrethimi të kryhet në pajtim me elaboratin gjeodezik i punuar nga "Geo Survej Xhila" Shpkknj Strugë me nr.0705-249/5 të datës 28.11.2018 dhe në pajtim me dokumentacionin teknik me numër 53/2018 nga nëntori 2018 të punuar nga SHPKKNJ "Emc-Kad" - Strugë.

Meqë se personat Nexhmi Hani nga f. Velestë dhe Stefan Tomanosovski nga Struga, dy herë ishte kryer dorëzim i pasuksesshëm për shkak se të njëjtit nuk banon në atë adresë jashtë vendit.

THIRRET

Personat e emëruar ose përfaqësues të tyre në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të shplljes, në Informatorin zyrtar të Komunës së Strugës dhe në gazeta ditore të cilat distribuohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, gjatë dy ditëve të njëpasnjëshme, kurse shpllje të njëhershme në Informatorin zyrtar të Komunës së Strugës, të **PARAQITET** në hapësirat e Komunës së Strugës - Sektorin për Urbanizëm, me qëllim në pajtim me nenin 62-1 paragrafi 1 nga Ligji për ndërtim të kryej shqyrtim në projektin e theksuar themelor si pale e interesuar.

PARALAJMËROHET personat e theksuar ose përfaqësues të tyre se në pajtim me nenin 86 paragrafi 3 nga "Ligji për procedurë të përgjithshme Administrative" se kjo mënyrë e dorëzimit llogaritet për dorëzim të rregullt dhe nëse të njëjtit nuk e bëjnë këtë në afatin e paraparë, pasojat negative të cilët mund të ndodhin do ti bartin palët.

Shtojcë: Fletëdorëzim nr.10-1992 të datës 27.12.2018 dhe fletëdorëzim nr 10-1992 të datës 29.12.2018.

Lajmërim nr.10-1992 të datës 27.12.2018.
Me respekt,
Komuna e Strugës

KOMUNA E STRUGËS
Kryetar i komunës,
Dr. Ramis Merko

v.v.

Përpiloi:
Aleksandar Bandoski
Lejoi:
Natmir Nexhipi

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 071 372 221

**Shesim tokë ndërtimi - 9000m2
Në Komunën kadastrale Zlokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m2.
Tel. 071/372-215 & 078/243-583**

Koha
http://www.koha.mk

www.koha.mk
koha@koha.com.mk
marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botimit dhe redaksionit: Bll. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Marovica 1000 - Prilep, Shkup

GRUSHTI I HEKURT I MAROTTAS, ICARDI ËSHTË VETËM I FUNDIT I NJË LISTE TË RËNDËSISHME

Drejtuesi zikaltër nuk i ka lënë vend interpretimeve dhe ka vendosur që Mauro Icardi të mos jetë më kapiten i Inter-it. Një zgjidhje, sipas shtypit italian, që ka ardhur nga mungesa e qetësisë e argjentinasi, i cili tani rrezikon të mos jetë një pikë referimi për Inter-in e së ardhmes

Marotta, njeriu me grushtin e hekurt. Drejtuesi zikaltër nuk i ka lënë vend interpretimeve dhe ka vendosur që Mauro Icardi të mos jetë më kapiten i Interit. Një zgjidhje, sipas shtypit italian, që ka ardhur nga mungesa e qetësisë e argjentinasi, i cili tani rrezikon të mos jetë një pikë referimi për Inter-in e së ardhmes. Nga ana tjetër, nuk është hera e parë që ish-drejtuesi i Juventus ndodhet në një situatë të tillë dhe lista e atyre që janë përballur me zemërimin Marottas është e mbushur me emra të rëndësishëm...



Ninja - Interisti i parë që është familjarizuar me metodat e ashpra të Marotta-s ka qenë Radja Nainggolan. Mesfushori i zikaltërve ka provuar menjëherë dorën e hekurt të drejtuesit të ri, i cili nuk është menduar dy herë për ta gjobitur lojtarin për jetën e natës, që nuk duket e denjë për një futbollist profesionist. Belgu duket se e ka mësuar leksionin dhe kohët e fundit ka thënë se do të jetë më i kujdesshëm në të ardhmen, edhe për të zgjatur me disa vite karrierën e tij.

Luftëtari - Duke qëndruar te lojtarët me karakter të vështirë, edhe Arturo Vidal, në kohën kur

luante me Juventus, ka paguar për disa sjellje të papërshtatshme, veçanërisht jashtë fushës. Me Marotta-n nuk mjafton të merren rezultate të mira në fushën e lojës, nëse nuk shoqërohen me një jetë prej profesionisti jashtë saj. Disa incidente, diplomatike dhe jo, nuk janë pëlqyer shumë dhe në Torino kanë vendosur ta largojnë. Kështu, kur është marrë oferta nga Bayern-i, Marotta nuk është menduar gjatë.

Përballje titanësh - Edhe Bonucci ka qenë i detyruar të përshtatet me filozofinë e Marotta-s. Pas finales së Cardiff-it, diçka mes tij dhe klubit ishte prishur. Drejtuesi

italian ka qenë i qartë, Bonucci nuk mund ta veshë më fanellën e Juventusit. Kështu, qendërmbrojtësi emigroi te Milan-i para se të kthehet në bazë 12 muaj më pas. Një rastësi që rikthimi i lojtarit ka ndodhur pas largimit të Marotta-s?

Altro ritorno - Edhe Caceres e ka paguar me largim nga Juventus sjelljen e papërshtatshme jashtë fushës. Daljet e shpeshta natën dhe rendimenti jo gjithmonë i mirë kanë shtyrë klubin që t'i thotë mirupafshim. Edhe ai, pikërisht si Bonucci, është kthyer në bazë pas lamtumirës së Marottas. Dy të dhëna janë një rastësi, apo përbëjnë një provë? Mes dyshimeve ka një siguri: me Marottan nuk bëhet shaka.

Lamtumira - Edhe rasti i Tevez bën pjesë me të drejtë në këtë listë. Këtë herë sjellja e lojtarit nuk hyn, ose të paktën nuk ndikon shumë. Sulmuesi argjentinasi ka shprehur dëshirën e tij, atë që të kthehet në atdhe. Marotta nuk e ka marrë mirë dhe i ka hapur derën argjentinasi, duke thënë për mediat: "Nuk mbajmë njeri kundër dëshirës". Duket se ish-drejtuesi i "Zonjës" po ndjek të njëjtën filozofi edhe tek Inter. Pas përballjes me Icardin, askush nuk e ka vendin të sigurt sezonin e ardhshëm.



Wenger zbulon përpjekjen për ta joshur yllin e ri të Cityt

Arsene Wenger ka zbuluar se u përpoq të nënshkruante me yllin e Borussia Dortmund, Jadon Sancho, gjatë kohës që ky i fundit ishte te Manchester City. Trajneri i njohur francez e ka fjalën për kohën kur ishte drejtues i Arsenalit. Tani në rolin e analistit sportiv televiziv, Wenger tha se dëshironte ta merrte yllin e Anglisë në Londër (nga Manchester City), pasi francezi e pa djaloshin e ri si një nga lojtarët më të mirë të brezit të tij. Sancho është kthyer në një yll për Dortmundin dhe Anglinë, që kur ka mbërritur në Bundesligë, në vitin 2017: "Doja të nënshkruaja me të nga Manchester City, kur nuk po merrte minuta në këmbë, nuk po aktivizohej. U përpoqa ta joshja atë, sepse është nga Londra. U përpoqa ta merrja tek Arsenali. Ai është një nga lojtarët më të mirë të brezit të tij, ka diçka që është pjesë e lojtarëve të mëdhenj". Wenger, i cili prej kohësh ka pasur reputacionin e menaxherit përkras të të rinjve, beson se shumtë e parave që iu ofrohen lojtarëve si Sancho, para se t'i fitojnë ato në fushë, mund t'i pengojë për t'u përmirësuar: "Presioni ndaj këtyre djemve të rinj, që nga moshja e hershme, është shumë i madh. Ata marrin shumë para, përpara se të luajnë ndeshje. Kjo bën që të mos përmirësohen në aspektin e urisë. Vihen në provë, sepse bëhen të pasur para se të luajnë". Me ndeshjen e së mërkurës, kundër Tottenham, Sancho u bë lojtari i shtatë anglez, që përballë me një skuadër angleze në Ligën e Kampionëve, si pjesë e një rivali jobritanik, duke ndjekur David Beckham, Ashley Cole, Owen Hargreaves dhe Steve McManaman. Për fat të keq për kryesuesit e Bundesligës, Sancho nuk ishte në gjendje të prodhonte ndonjë "magji" të vërtetë kundër "Spurs", në humbjen 3-0.


Valverde, Messi, Neymar e Coutinho, presidenti i Barcelonës zbulon sekretet

Presidenti i Barcelonës, Josep Maria Bartomeu, gjatë një interviste të gjatë për stacionin radiofonik "RKB" ka folur për ato që janë çështjet për të nxehta në kampin katalanas, mes objektivave, të ardhmes së trajnerit e gjithashtu të Lionel Messi, për të diskutuar gjithashtu edhe për Neymar e Coutinho. "Tripleta është gjithmonë ambicia jonë kur nis sezoni. Të gjithë flasin për Champions League, por ne jemi të interesuar për të fituar të gjithë titujt. Për ne janë prioritet La Liga, Champions League dhe Kupa e Mbretit. Futbollistët kanë ambiciet për të fituar gjithçka, ose të paktën të shkojnë në finale. Unë dua që Valverde të qëndrojë dhe ju e dini këtë fakt. Ai ka një kontratë, por do të vijë një moment kur ai nuk do të drejtojë më Barçan. Unë jam i kënaqur me mënyrën se si ai po i bën gjërat. Ernesto do të vazhdojë te Barça edhe vitin e ardhshëm". "Ai është mjaftueshëm i fuqishëm për të vazhduar edhe një vit të tretë, madje e shoh më të qetë në punën e tij. Valverde do të jetë trajneri i Barças vitin e ardhshëm edhe



nëse nuk fiton asgjë këtë sezon. Ai është një garanci më shumë për futbollistët e rinj si Arthur, Lenglet, Dembélé, De Jong apo Todibo". "Messi do të bëjë edhe një rinovim tjetër të sigurt të kontratës, sepse ai kujdeset shumë mirë për veten e tij. Roli i tij në skuadër është i qartë dhe ai ka akoma dhe shumë vite të tjera futbollit të mbetura". "As Neymar dhe as babai i tij nuk më kanë kontaktuar. Unë kam folur me atë kur jam përballur, por as ai dhe as babai i tij nuk më kanë

thënë se duan të rikthehet te Barça. Ai ka një kontratë me PSG. Disavantazhi ynë ishte se kishim një klauzolë". "Coutinho po kalon një periudhë të vështirë, por unë jam i sigurt se do ta rishohim sërish në formë pas disa javësh. Kundër Sevilla-s ai na dëshmoi se është i një niveli të lartë. Është një bast serioz, ishte një investim i kushtueshëm dhe besojmë shuëm tek ai", deklaroi ndër të tjera presidenti i Barcelonës, Josep Maria Bartomeu.



Andre Silva dëshiron kthimin te Milani

Do të kthehem te Milani, vetëm nëse më premtohet vendi i titullarit, ka deklaruar për Gazzetta dello Sport, sulmuesi i Sevilias, Andre Silva. Silva iu bashkua spanjollëve si huazim me të drejtë blerjeje nga Milani verën e kaluar dhe ka shënuar 11 gola me klubin andaluzian, por ish-sulmuesi i Portos, ka shtuar se ende nuk ka përfunduar punën në "San Siro" dhe se i mungon Italia. "A më mungon Italia? Po. Futbolli nuk është sport individual. Mund të kesh pritshmëri, por nuk je vetëm dhe duhet të të ndihmojnë. Jam i lumtur për ecurinë e Milanit. Jam mirë këtu, por jam lojtar i Milanit. Nëse do të zgjidhja të jem titullar te Sevilla dhe të mos luaj te Milani, do të zgjidhja të rri në Spanjë", ka deklaruar Silva për "Gazzetta dello Sport".



SOLARI: I LUMTUR ME PARAQITJEN E LOJTARËVE

"Jam shumë i kënaqur me paraqitjen e të gjithëve, për të fituar këtu, ishte e nevojshme që secili prej lojtarëve të bënte një përpjekje dhe të jepte maksimumin. Kjo është Liga e Kampionëve dhe nuk ka ndeshje të lehtë ose skuadra të thjeshta, ata na e kanë bërë të vështirë për të fituar", ka deklaruar Solari

Real Madridi ka fituar ndaj Ajaxit me rezultat 1-2 në stadiumin Johan Cruyff Arena në ndeshjen e parë të fazës eliminuese (1/8 e finales) në Ligën e Kampionëve. Skuadra holandeze befasoi me lojën e mirë, por në fund përvoja e Los Blancos u tregua vendimtare. Rastin e parë serioz për gol e kishte Ajaxi në minutën e nëntë me anë të Noussair Mazraoui. Reali iu përgjigj me anë të Vinicius Junior (14'), por Andre Onana bëri një pritje të mirë. Ajaxi vazhdoi dominimin, raste për gol kishte me anë të Dusan Tadic (26'), Hakim Ziyech (36'). Në minutën e 37-të shënoi Nicolas Tagliafico, por gjyqtari anuloi golin pas konsultimit me VAR-in. Në pjesën e dytë Los Blancos luajtën më mirë, Karim Benzema (51') kishte rast të mirë për gol, por Onana nuk lejoi edhe një herë

që rrjeta e tij të tundet. Benzema kaloi Realin në epërsi në minutën e 60-të pas asistimit të bukur nga Vinicius. Goli i barazimit u shënuar nga Hakim Ziyech në minutën e 75-të, por mysafirët pas këtij goli sulmuan më shumë dhe në minutën e 87-të rikthyen epërsinë me anë të Marco Asensios dhe me rezultatin 1-2 përfundoi ndeshja. Tottenham ka arritur të shënojë fitore ndaj Borussia Dortmundit me rezultat 3-0. Londinezët e nisën mirë ndeshjen duke rrezikuar me Lucasin, por që nuk arritën të shënojnë. Thomas Delaney u kundërpërgjigj, por Hugo Lloris ishte në vend. Pjesa e parë nuk solli më raste, por e dyta ishte e jashtëzakonshme. Me të filluar pjesa e dytë, Heung-Min Son shënoi për 1-0. Londinezët nuk u ndalën, kur Serge Aurier harkoi te Jan Vertonghen


i cili në minutën e 83-të shënoi për 2-0. Tottenham shënoi edhe një herë me Fernando Llorenten në minutën e 87-të për 3-0. Trajneri i Real Madridit, Santiago Solari, ka folur pas ndeshjes ndaj Ajaxit. Ai tha se është i kënaqur me paraqitjen e lojtarëve të tij, sidomos të Asension që edhe shënoi. "Jam shumë i kënaqur me paraqitjen e të gjithëve, për të fituar këtu, ishte e nevojshme që secili prej lojtarëve të bënte një përpjekje dhe të jepte maksimumin. Kjo është Liga e Kampionëve dhe nuk ka ndeshje të lehtë ose skuadra të thjeshta, ata na e kanë bërë të vështirë për të fituar. Jam i kënaqur me performancën dhe golin e Asensios, sot e kam vërejtur rritjen e tij. Goli i VAR? Trajnerët nuk kanë monitor për të parë përsëritjen dhe atë që ndodh, ne besojmë në VAR dhe te gjyqtarët. Ne jemi

mësuar të punojmë, ta vuajmë dhe të shënojmë kur luajtmë. Ata na mbyllën, na sulmuan, ndonjëherë në mënyrë agresive, në kufi të rregullores, ata dhanë të gjitha energjitë e tyre për ndeshjen e sotme", ka deklaruar Solari.

Real Madridi mori një fitore të rëndësishme në ndeshjen e parë kundër Ajaxit në Ligën e Kampionëve, ku kapiteni Sergio Ramos, u nda i kënaqur me rezultatin. Karim Benzema i dha epërsinë kampionëve evropianë dhe botërorë, ndërsa Marco Asensio e vulosi fitoren për Los Blancos. "Ajax rritet kur luan në shtëpi dhe ata ngritën edhe paraqitjen e tyre. Ata bënë presing shumë të lartë dhe nuk na lejonin të merrnim topin kështu që filluam ta kërkojmë daljen me topa të gjatë. Tani është koha që ata të vuajnë para tifozëve tanë", tha fillimisht Ramos. Sezoni i Real Madridit është kthyer gjatë javëve të fundit dhe po ashtu, tani janë pozicionuar mirë edhe në Ligën e Kampionëve. "Ne kemi qenë të efektshëm, mbi të gjitha. Futbollit nuk është gjithmonë një lojë e bukur dhe ne duhet të dimë se si t'i interpretojmë ndeshjet. Ne duhet të krijojmë hapësirë dhe pastaj të përfitojmë", ka deklaruar Ramos.

UEFA SHPJEGON ARSYEN E ANULIMIT TË GOLIT NË FAVOR TË REAL MADRID

Nicolas Tagliafico shënoi me kokë kundër Real Madrid në Minutën e 38'-të në pjesën e parë. Por, arbitri kryesor i kësaj ndeshje, slloveni Damir Skomina vendosi ta shohë në përsëritje këtë moment dhe e cilësoi të parregullt golin. Arsyja e saktësuar nga UEFA për rastin në fjalë: "Goli me kokë i Tagliafico u




cilësua pozicion jashtë loje pas përsëritjes së VAR. Gjyqtari pa që Dusan Tadic, shok skuadre i Tagliafico, ishte pozicion jashtë loje dhe pengoi portierin". Me këtë sqarim UEFA kërkon të shuajë të gjitha kritikët dhe dyshimet ndaj vendimit të arbitrit slloven.



Marek Hamsik në Kinë, do të përfitojë 27 milionë për tre vjet

Ka përfunduar pas 12 viteve aventura e Marek Hamsik me Napolin. Futbolisti sllovak do të transferohet në Kinë te skuadra Dalian, ku do të përfitojë 9 milionë euro neto në sezon për tre vitet e ardhshme. Në arkat e Napolit do të kalojnë 5 milionë euro menjëherë dhe 15 të tjera vitin e ardhshëm. Zyrtarizimi u bë nga avokati Mattia Grassani, përfaqësues ligjor i Napolit. "Hamsik është një lojtar i Dalian nga ora 20:30 e mbrëmjes." Pas një një stopimi disaditor, telenovelës "Hamsik" i erdhi fundi. Sllovaku, që aktualisht ndodhet në vendlindjen e tij, qytetin Banska Bystrica, do të udhëtojë drej Kinës këtë të enjte. De Laurentis ia dha leje kalimin vetëm pasi mori garanci nga banka kineze për paratë që do të përfitojë nga klubi i vendin aziatik.



Rakitiq dëshiron qëndrimin

Barcelona nuk e ka në plan t'ia vazhdojë kontratën mesfushorit Ivan Rakitiq, pavarësisht se futbollisti e dëshiron një gjë të tillë, raporton "Diario Sport". Kroatit, kontrata momentale në "Camp Nou" i përfundon në verën e vitit 2021, dhe mosvazhdimi i kontratës së tij, ka të bëjë me ardhjet si Arturo Vidal, Arthur Melo dhe Frenkie de Jong që do t'i bashkohet skuadrës në verë nga Ajaxi. Javën e kaluar, "Diario Sport" ka bërë të ditur se për nënkampionin e Botës me Kroacinë, janë interesuar një numër i madh i klubeve, përfshirë këtu Chelsea dhe Interin. Rakitiq me Barçën ka fituar katër Kupa të Mbretit dhe Ligën e Kampionëve, me 33 gola të shënuar në 245 paraqitje.



Sarri në pikëpyetje, Chelsea kontakton me Zidane

Maurizio Sarri mori votëbesimin e Abramoviç, pas humbjes së Chelseat me rezultatin e thellë 6-0 në transfertën ndaj Manchester City-t, por muaji shkurt do të jetë vendimtar për të ardhmen e teknikut italian në stolin e bluve të Londrës. Kjo pasi skuadrën e presin një sërë përballjesh mjaft të vështira, të cilat nëse nuk shkojnë me suk-

ses, mund të mbyllin bashkë me muajin më të shkurtër të vitit, edhe aventurën e Sarrit në stolin e Chelseat, pasi kujtojmë që londinezët do të përballen dy herë me Malmon, por edhe me skuadra si United, City dhe Tottenham. "The Sun" ka raportuar sot se drejtuesit e klubit janë vënë menjëherë në lëvizje, për të pasur një plan B në dispozi-

cion, nëse nuk do të konfirmohet Sarri dhe pikërisht për këtë arsye, kanë vendosur kontaktet e para me Zinedine Zidane. Ish trajneri i Realit po shijon pushimet, pas 3 triumfesh radhazi në Champions, por mbetet në pritje të një projekti joshës për të ardhmen. Londinezët janë të gatshëm t'i plotësojnë dëshirat Zidane, për ta ulur në stol,

pasi me francezin, synohet që të bindet edhe Hazard, që të qëndrojë akoma te Chelsea. Vlen të theksohet se krahas rezultateve, pozitativ e Sarrit janë komplikuar edhe për shkak të marrëdhënieve aspak të mira me një pjesë të futbollistëve, përfshi këtu kapitenin Hazard, yllin francez N'golo Kante, por edhe të tjerë emra.

Koha, e premte, 15 shkurt 2019

DASHI 21. mars - 20. prill

Jeta sentimentale për ju çiftet nuk do jete aspak problematike sot. Përkundrazi dita do jete plot diell dhe e mbushur me emocione te këndshme. Beqaret duhet thjesht te tregohen me te vëmendshëm sepse edhe mund ta gjejnë sot dashurinë qe kane ëndërruar prej kohesh. Ne planin financiar do kryeni transakcione te rëndësishme sepse gjendja do jete e shkëlqyer.

DEMI 21. prill - 21. maj

Nëse jeni ne çift ndikimi i yjeve për ditën e sotme do jete shume i favorshëm. Do merreni vesh shume mire me atë qe keni ne krahe dhe nuk do keni me debate si dikur. Beqaret duhet te tregohen me te duruar dhe te mos nxitohen te hedhin hapa. Do vijje edhe për te momenti special. Saturni do ndikoje tek financat dhe do ju ndihmoje te grumbulloni me shume se zakonisht.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Marrëdhënia juaj me partnerin do jete shume e ngrohte sot. Do dini si te ruani një komunikim te ngrohte dhe do toleroni me tepër nga me pare. Beqaret ka rrezik te zhgënjehen nga disa persona qe ne dukje ishin perfekte. Fatmirësisht qe nuk do kenë bere premtime. Financat nuk do jene te shumta dhe duhet patjetër te tregoheni te kujdesshëm. Nga ana tjetër nuk këshillohet as te merrni hua.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Merkuri do ua zbukuroje tej mase jetën gjate kësaj dite. Harmonia do mbizotërojë ne çdo moment dhe kënaqësitë do jene me te forta se me pare. Beqaret do kenë ditën ideale për te bere projekte për te ardhmen pasi do realizojnë takime interesante. Paratë nuk do jene te shumta dhe duhet patjetër te tregoheni te kujdesshëm. Nga ana tjetër nuk këshillohet as te merrni hua.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Urani do jete pozicionuar keq gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift dhe here pas here mund te keni edhe debate me partnerin. Do e kritikoni atë edhe për pamjen dhe sjelljen prandaj situata mund te tensionohet me shume. Beqaret mund te realizojnë takimin e tyre te ëndrrave, por nuk duhet te nxitohen për asgjë. Buxheti nuk do jete i shkëlqyer dhe çdo hap duhet hedhur me kujdes.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Fati do ju buzëqeshë ne çdo moment sot juve qe jeni ne një lidhje. Do ja kaloni mjaft mire pranë te dashurit te zemrës dhe nuk do doni te ndaheni për asnjë çast. Beqareve do ju plotësohen dëshirat dhe do e ndryshojnë shpejt statusin ne te cilin ndodhen. Ne planin financiar do i zgjidhni me maturi problemet dhe do jeni shume me te qete se disa kohe me pare.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Fati do jete ne anën tuaj gjate kësaj dite. Do shkoni neper vende te veçanta me partnerin dhe do përjetoni emocione e kënaqësi pa fund. Beqaret nuk duhet te nxitohen për asgjë. Nëse dikush nuk ua mbush mendjen plotësisht mbajeni larg. Me financat tregohuni sa me te arsyeshëm ne mënyrë qe gjendja te filloje te përmirohet. Ju mund t'ia dilni mbanë.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Shfrytëzojeni sa te mundni çdo minute qe do kaloni pranë partnerit tuaj sot dhe keni për t'u ndier për mrekulli. Priten surpriza dhe çaste fantastike te cilat duhen shfrytëzuar ne çdo moment. Beqaret nuk do kënaqen nga takimet qe do realizojnë dhe do preferojnë te qëndrojnë vetëm. Buxheti do jete gjithë kohës i mbrojtur prandaj mund te kryeni edhe ndonjë shpenzim me tepër.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do jeni melankolike gjate gjithë kësaj dite ju te dashuruarit dhe do i merrni gjerat si t'iu vijnë. Nuk priten probleme apo vështirësi te mëdha. Beqaret do përjetojnë emocione dhe kënaqësi pa fund fale disa personave qe do i joshin ne çdo moment. Me siguri qe do pranojnë qe sot ta ndryshojnë statusin. Financat nuk do jene te këqija, por as fantastike. Tregohuni te kujdesshëm.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dite goxha e trazuar dhe e zymte kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Duhet te mateni me fjalët qe do i thoni partnerit nëse nuk doni qe çdo gjë te marre fund përgjithmonë. Beqaret do kenë takime, por asnjeri nuk do ju duket i veçante. Edhe sot kane për te mbetur vetëm. Ne planin financiar do i bëni mire llogaritje dhe gjithçka do ece si duhet.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Mos u tregoni kokëfortë sot ne jetën tuaj ne çift dhe pranoi here pas here te hapni rruge. Partneri nuk do jete ne humorin e duhur dhe mund te acarohet për gjithçka. Beqaret do kenë me shume fat se me pare dhe do e ndryshojnë statusin. Gjendja e financave do jete e trazuar për shkak te shpenzimeve te pallogaritura qe keni kryer se fundmi.


PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do përjetoni emocione te shumta sot ju te dashuruarit dhe do ëndërroni here pas here. Partneri do ju beje te ndiheni mire. Beqaret do jene gati te bëjnë gjithçka vetëm qe te mos qëndrojnë me statusin qe kane pasur deri me sot. Ne planin financiar fati do jete me ju. Do arrini t'i kryeni edhe disa investime te cilat me pare nuk kishit mundur t'i bënit.

shumë i tërësë

			9	7	3	5		1
			5		1			
	2							
2	5						1	7
3				4				5
4	1						8	9
			4		8	7		
5		1	7	3	6			

SOT MË 15 SHKURT 2019 BËHEN TREMBËDHJETË VJET PA TY



Shaban Murati

U ndave nga ne vetëm fizikisht, por në zemrat tona je i gjallë dhe shumë i respektuar.

Nga familja

	Messazhi	SOT I SHKURTIT			LUNDË I SHKURTIT			MARTË I SHKURTIT			ENJTE I SHKURTIT			DIELI I SHKURTIT			B
	Udhëzime																
	Lehtësi																
	Probleme																
	Shprehje																
	Q																
Durimi	Z	O	T	I													
Koha	U	SHTATË			PËNËNTO			KËSHTË			PËNËNTO						
	U	DH	A	SH	T	Ë											
		SHTATË			PËNËNTO			KËSHTË			PËNËNTO						
M																	
F	A	M	I	L	J	A	R	Ë	V	E							
M																	
F							A	M	I	N							

DOVA, FILLIME AMIN.
 ZGJIDHETË B. VELA. AKRILLI. BROGA. GËNVAN. ZOLL. U. LAM. K. U. DHASHTË. IRE. LAPRAKVA. UT. T. R. DURIM. MILITARE. NA. MILD. T. BOH. FAMILLJAREVE. TALE. RONAN. MUNIRA. ND. I. MELHA.

DYQANI I BUKËS KËRKON PUNËTORË ME 1400 EURO NË MUAJ!

Kërkohet punëtor me rrogë 1400 euro në muaj, por nuk gjendet asnjë që të jetë i gatshëm që të punojë natën. Historia vjen nga Reschigliano di Campodarsego, provincë e Padova në Itali, ku një furrë buke, kërkon punonjës për përgatitjen e bukës. Prej kohësh në xham qëndron varur tabela "Kërkohet punëtor", por të zotët e dyqanit Stefano Brigato dhe Guglielmo Peruzzo, nuk kanë arritur që ta gjejnë ende. Ata thonë se bëhet fjalë për një punë me orar të plotë dhe me kontratë të rregullt, por shprehen se nuk po gjejnë dot punonjës, pasi askush nuk shprehet i gatshëm për të punuar natën. Bëhet me dije se puna nis në orën 02.00 të natës dhe përfundon në 9 të mëngjesit. Pjesa më e madhe e procesit është automatik, por pavarësisht kësaj dhe rrogës së ofruar, vendi është ende bosh. Për këtë arsye Stefano Brigato dhe Guglielmo Peruzzo, vendosën ta bëjnë rastin publik në media, në mënyrë që të mund të gjejnë punëtor për



prodhimin e një produkti kaq jetik, siç është buka.

Megjithatë, shumë kandidatë - shpesh të rinj - nuk i pranojnë këto kushte. "Shoqata jonë tregtare duhet të bashkëpunojë

më shumë me shkollat e hoteleve për të aktivizuar, për shembull, kurse buke, - sh-ton bukëpjekësi - Ne duhet t'i bëjmë të qartë të rinjve se kjo tregti gjithmonë i reziston krizës".



Zyrtarët hajdutë që "zhdukën" 300 makina luksi

Policia në Papua Guinean e Re u kërkoi zyrtarëve lokalë të kthejnë mbrapsht rreth 300 makina të huazuara nga ata vitin e kaluar gjatë Samitit ndërkombëtar për Bashkëpunimin Ekonomik Azi-Paqësor (APEC). Flota luksoze e makinave u importua në mënyrë që liderët e vendeve të tjera të lëviznin në kushte komode në një vend që është i zhytur në varfëri. Por një zyrtar i policisë tha të martën se 284 automjete nuk janë dorëzuar mbrapsht. Inspektori Dennis Corcoran tha se në mesin e makinave të pakthyera janë edhe marka si Landcruiser, Ford, Mazda dhe Pajero. Policia ka krijuar edhe një ekip special për gjetjen e makinave në kryeqytetin e Papua Guinesë së re, Port Moresby. "Janë 284 makina që u janë lëshuar personelit për përdorim gjatë Samitit të APEC-it që nuk janë kthyer mbrapsht", tha Dennis Corcoran për Reuters. Fatmirësisht, vendndodhja e makinave më të shtrenjta të markave Maserati - me vlerë mbi 100 mijë dollarë, është lokalizuar. Sipas autoriteteve nëntë prej makinave janë vjedhur dhe disa të tjera u janë hequr pjesë të ndryshme, ndërsa disa të tjera janë kthyer tepër të dëmtuara.

Pavarotti në një dokumentar

Mbrëmjen kur u ndanë çmimet Grammy, kompania filmike "CBS Films" publikoi një pjesë nga dokumentari që po përgatit për tenorin e madh italian, Luciano Pavarotti. Projekti ende është në fazën e prodhimit. Magjia e zërit të tij është e njohur në mbarë botën, ndaj regjisori Ron Howard do të përpiqet të sjellë anën njerëzore të Pavarotti-t. Familja e tenorit i ka dhënë akses të plotë atij për të hyrë në arkin e Luciano Pavarotti-t, që nga intervistat që ka zhvilluar e deri tek performancat live në disa shtete. Luciano Pavarotti mbetet një nga zërat me mahnitës, i cili u duartrokoi nga e gjithë bota dhe mbi të gjitha riktheu operën te njerëzit. Dokumentari pritet të dalë në kinematë amerikane më 7 Qershor.



80 për qind e priftërinjve në Vatikan janë homoseksual!

Disa nga klerikët më të mëdhenj të Kishës Katolike Romake, të cilët vazhdimisht kanë dalur kundër homoseksualitetit, janë vet homoseksual, sipas një libri që pritet të publikohet javën e ardhshme. 80 për qind e priftërinjve që punojnë në Vatikan janë homoseksual, ndonëse jo seksualisht aktivë, thuhet në librin "Brenda dollapit të Vatikanit". Libri që përbehet prej 570 faqeve është një "tregim befasues i korrupsionit dhe hi-

pokrizisë në zemër të Vatikanit", sipas bo-tuesit britanik Bloomsbury, shkruan The Guardian.

Libri pritet që të publikohet të mërkurën e ardhshme, në tetë gjuhë, në 20 vende të ndryshme të botës. Kjo datë është caktuar jo rastësisht me ditën e hapjes së një konference në Vatikan për abuzimin seksual, në të cilën janë thirrur peshkopë nga e mbarë bota.



- 399 - Filozofi Sokrati dënohet me vdekje.
- 590 - Kiswa II kurorëzohet mbret i Persisë.
- 1563 - Trupat ruse okupojnë Polotsk, Lituania.
- 1689 - Parlamenti gjerman i shpall luftë Francës.
- 1763 - Austria, Prusia dhe Saksônia nënshkruajnë Paqen e Hubertusburgut.
- 1919 - Legjioni Amerikan organizohet në Paris.
- 1929 - Masakra e Shën Valentinit në Çikago.
- 1933 - Kandidati për kryetar Franklin Roosevelt mbijeton tentimin për vrasje.
- 1936 - Hitleri shpall konstruktimin e Volkswagen-it.
- 1942 - Singapori i dorëzohet Japonisë.
- 1984 - 500,000 ushtarë iranian futen në Irak.
- 1996 - Sulm ndaj Ambasadës amerikane në Athinë, Greqi.

KALENDARI HISTORIK 15 SHKURT




ÇFARË NDODH NËSE RRINI GJATË GJITHË KOHËS ONLINE

Rrjetet sociale rrisin vetëpëlqimin. Realiteti në të cilin jetojmë, aty ku kryesisht virtualja mbizotëron edhe mbi realen, është një fenomen që po vë në krizë unin tonë. Sipas specialistëve të neuroshkencës e psikoanalistëve të mbledhur në një konventë në Romë, me titullin "Exploring the Self", të qëndrosh në mënyrë konstante në linjë është një faktor që rrit patologjitë që lidhen me narcizmin. Pra krijohet një fokusim më i lartë mbi veten duke lënë pas dore realen, por edhe duke krijuar një sens dobësie ndaj botës që na rrethon. Sipas specialistëve, aty ku uni është më pak i strukturuar, atëherë edhe rreziku për të rënë pre e qëndrimit të tepruar në rrjetet sociale është më i lartë. Në këtë mënyrë, njeriu, veçanërisht të rinjtë, gjejnë këtë mënyrë për të thënë që "unë ekzistoj" dhe çdo gjë bëhet si një rreth vicioz duke ulur interesin për atë që i rrethon.

A E DINI SE...

THËNIA E DITËS



Populli është i madh kur jep njerëz të mëdhenj!
(Duhameli)